

LIGJ
Nr.8609, datë 8.5.2000

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
PËRKUFIZIME DHE PARIME

Neni 1
Qëllimi i këtij Kodi

Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave:

- a) për votimin për zgjedhjet për Kuvendin, për organet e qeverisjes vendore dhe në referendum;
- b) për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të zgjedhjeve;
- c) për përgatitjen dhe rishikimin e listave të zgjedhësve;
- ç) për caktimin e zonave zgjedhore;
- d) për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe financimin e tyre;
- dh) për pasqyrimin e fushatave zgjedhore nga ana e mediave;
- e) për zhvillimin dhe vlefshmërinë e referendumeve;
- ë) për procedurat e votimit dhe të nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve;
- f) për shkeljet penale dhe administrative të dispozitave të këtij Kodi.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Kodi:

1. “Data e zgjedhjeve” është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës dhe nuk përfshin datën kur mund të zhvillohet një raund i dytë votimi.
2. “Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë.
3. “Kandidat” është një shtetas shqiptar, i regjistruar në komisionet e zgjedhjeve si kandidat për deputet, ose për kryetar bashkie ose të komune, ose për këshillin e bashkisë ose të komunës, në përputhje me këtë Kod, për të cilin do të votohet në zgjedhje.
4. “Kandidat i pavarur” është një kandidat për deputet, ose për kryetar bashkie ose komune, ose për këshillin e bashkisë ose të komunës, që nuk mbështetet nga asnjë parti politike.
5. “Kandidat i përbashkët” është një kandidat i zonës njëemërore ose i një njësie zgjedhore, i cili mbështetet nga dy ose më shumë parti politike.
6. “Koalicion” është një grupim i dy ose më shumë partive politike të regjistruara në KQZ, të cilat paraqesin një listë shumëemërore të përbashkët për zgjedhjet për Kuvendin ose për organet e qeverisjes vendore.
7. “KQV” është Komisioni i Qendrës së Votimit.
8. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i krijuar sipas nenit 154 të Kushtetutës.
9. “KZQV” është Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore.
10. “KZZ” është Komisioni i Zonës Zgjedhore.
11. “Listat e zgjedhësve” janë dokumente zyrtare të regjistrimit të zgjedhësve për çdo zonë të qendrës së votimit, të parashikuara në përputhje me këtë Kod.

12. “Listë shumëmemërore” është lista e kandidatëve të një partie politike ose koalicioni, e cila miratohet nga KQZ-ja dhe shërben për zgjedhjen e kandidatëve në sistemin proporcional.

13. “Njësi zgjedhore” është një zonë zgjedhore, ose një bashki ose komunë në rastin e zgjedhjeve vendore.

14. “Parti politike” është një parti e regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”.

15. “Periudhë e zgjedhjeve” është periudha nga 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve, deri në shpalljen përfundimtare të rezultateve të votimit.

16. “Përfaqësues i subjektit zgjedhor” është një person i autorizuar nga një kandidat ose parti politike e regjistruar, për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore, në emër dhe për llogari të kandidatit ose të partisë.

17. “Qendër votimi” janë mjediset e caktuara për zhvillimin e votimit, në përputhje me këtë Kod.

18. “Raundi i dytë” është zhvillimi i një votimi të dytë në një njësi zgjedhore për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar të votave në datën e zgjedhjeve, sipas këtij Kodi.

19. “Referendum kushtetues” është referendum i zhvillohet sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

20. “Referendum i përgjithshëm” është referendum i zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës.

21. “Referendum vendor” është referendum i zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

22. “Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve” është dokumenti zyrtar ku regjistrohen të gjithë zgjedhësit e Republikës së Shqipërisë.

23. “Rishikimi i listave” është procesi i fshirjes ose i shtimit të emrave ose i ndryshimit të të dhënave në listat e zgjedhësve.

24. “Student” është çdo zgjedhës i regjistruar si student me shkëputje nga puna në një program arsimimi ose kualifikimi profesional në Shqipëri për jo më pak se tre muaj, vendqendrimi i të cilit për qëllimin e edukimit ose të kualifikimit është i ndryshëm nga vendbanimi i tij.

25. “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike dhe koalicionet e regjistruara në KQZ, si dhe kandidatët e tyre dhe kandidatët e pavarur të regjistruar në KZZ ose KZQV.

26. “Vendbanim” është vendi ku zgjedhësi është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, sipas nenit 12 të Kodit Civil.

27. “Vendqendrim” është vendi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku zgjedhësi ndodhet përkohësisht, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil.

28. “Zgjedhës” është çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote.

29. “Zgjedhës në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit” janë të gjithë zgjedhësit që shërbejnë në forcat e armatosura ose në forcat e rendit, me vendqendrim në një repart ushtarak ose të rendit.

30. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për organet përfaqësuese të qeverisjes vendore ose në referendum.

31. “Zgjedhje të pjesshme” janë votimet për të plotësuar vendin e njërit prej 100 deputetëve të zgjedhur në zonat njëmemërore ose vendin e kryetarit të bashkisë ose të komunës, si dhe për zgjedhjen e një këshilli të ri vendor në rast shpërndarjeje.

32. “Zonë e qendrës së votimit” është një zonë gjeografike brenda territorit të një bashkie, komune ose zone zgjedhore, e përcaktuar në përputhje me këtë Kod.

33. “Zonë zgjedhore” është një nga 100 ndarjet gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë, e përcaktuar në përputhje me Kushtetutën, si dhe me rregullat e këtij Kodi, në të cilën votohet për zgjedhjen e një deputeti.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

2. Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

3. Zgjedhësit ushtrojnë lirisht të drejtën e votës në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

4. Zgjedhësit janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

5. Ndarja e zonave zgjedhore bëhet duke përfshirë në secilën prej tyre një numër afërsisht të barabartë zgjedhësish.

6. Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor ose të një alternative referendare, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

7. Subjektet zgjedhore janë të lira të bëjnë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

8. Komisionet zgjedhore, të parashikuara në këtë Kod, i përmbushin funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente.

Neni 4

Caktimi i datës së zgjedhjeve

Data e zgjedhjeve caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, sipas rregullave të parashikuara në nenet 65, 109, 115, 151 pika 3, 152 pika 3 dhe 170 pika 6 të Kushtetutës.

2. Raundi i parë i zgjedhjeve për Kuvendin zhvillohet 60 deri në 30 ditë para mbarimit të mandatit të tij dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij.

3. Raundi i parë i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore zhvillohet 60 deri në 30 ditë para mbarimit të mandatit të organeve vendore ekzistuese ose jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes ose shkarkimit të tyre. Në rast ankimi të organit të shpërndarë ose të shkarkuar, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 45 ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në rast të mosushtrimit të së drejtës të ankimit nga organi i qeverisjes vendore të shpërndarë ose të shkarkuar, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë pas mbarimit të afatit të ankimit, të parashikuar në nenin 115 pika 3 të Kushtetutës.

Dekreti për caktimin e datës së zgjedhjeve përmban datën e zgjedhjeve dhe datën e zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve.

Zgjedhjet zhvillohen në një ditë të diel.

Neni 5

Orari i votimit

1. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 31 marsit dhe 15 tetorit, qendrat e votimit hapen në orën 800 dhe mbyllen në orën 1800.

2. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 16 tetorit dhe 30 marsit, qendrat e votimit hapen në orën 700 dhe mbyllen në orën 1800.

3. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes të qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.

PJESA E DYTË

ZGJEDHËSIT, SUBJEKTET ZGJEDHORE, VËZHGUESIT

KREU I

ZGJEDHËSIT

Neni 6

Kushtet për të qenë zgjedhës

1. Çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve ose para saj dhe që plotëson kushtet e parashikuara në këtë Kod, ka të drejtë të votojë për zgjedhjet për Kuvendin, për

organet e qeverisjes vendore dhe në referendume.

2. Përfshihen nga e drejta për të zgjedhur shtetasit e shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si të pa zotë për të vepruar, për shkak të paafësisë mendore.

Neni 7

Vendi i votimit të zgjedhësve

Zgjedhësit votojnë në qendrën e votimit në zonën e së cilës ata janë regjistruar në listën e zgjedhësve.

Neni 8

Zgjedhësit që banojnë jashtë shtetit

Zgjedhësit që banojnë në një shtet tjetër kanë të drejtë të votojnë vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në vendin ku janë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, me kusht që të jenë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të jenë pajisur me kartën e zgjedhësit, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

Neni 9

Zgjedhësit që ndodhen në vende të posaçme

Zgjedhësit, që në datën e zgjedhjeve ndodhen në institucione të posaçme ose në reparte ushtarake ose të rendit, si dhe studentët, votojnë sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

KREU II

KANDIDATËT

Neni 10

Kushtet për të qenë kandidat

1. Kandidati për deputet, përveç kushteve për të qenë zgjedhës, duhet të plotësojë edhe kushtet e pikës 3 të nenit 45 dhe nenit 69 të Kushtetutës.

2. Kandidati për organet e qeverisjes vendore, përveç kushteve të parashikuara në nenin 45 të Kushtetutës, duhet të jetë shtetas me vendbanim në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Kandidati për organet e qeverisjes vendore nuk mund të jetë deputet në Kuvend ose kandidat për deputet.

Kandidatët e listave të partive, të depozituara në komisionet e zgjedhjeve, duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 11

Plotësimi i vendeve vakante në organet e zgjedhura

Kur vendi i deputetit në Kuvend mbetet vakant, ai plotësohet me një anëtar të ri.

Kur mandati i një deputeti të zgjedhur nga lista shumëpartiake e një subjekti zgjedhor mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës në listë.

Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëpartiake mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga një deputet i ri i zgjedhur nga zgjedhësit e së njëjtës zone zgjedhore. Presidenti i Republikës, mbi bazën e njoftimit të menjëhershëm të Kryetarit të Kuvendit, cakton me dekret datën e zgjedhjeve të pjesshme në atë zonë, jo më vonë se 45 ditë nga marrja e njoftimit. Deputeti, i zgjedhur për plotësimin e vendit vakant, shërben deri në fund të mandatit të deputetit të larguar.

Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëpartiake mbaron në mënyrë të parakohshme gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumëpartiake të subjektit zgjedhor përkatës. Në rast se gjatë kësaj periudhe mbaron mandati i një deputeti të pavarur, ai nuk zëvendësohet.

Kur vendi i kryetarit të bashkisë ose komunës mbetet vakant, brenda dy javëve Këshilli i

Ministrave njofton Presidentin e Republikës. Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve të pjesshme për zgjedhjen e kryetarit të ri të bashkisë ose komunës, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit. Kur vendi i këshilltarit në këshillat e bashkisë ose të komunës mbetet vakant, ai plotësohet nga kandidati i radhës së listës shumemërore përkatëse.

Në qoftë se vendi i kryetarit të bashkisë ose komunës mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në fund të mandatit.

Zgjedhjet e pjesshme zhvillohen sipas të njëjtës procedurë si zgjedhjet e përgjithshme.

KREU III PARTITË POLITIKE

Neni 12 **Regjistrimi i partive politike**

Çdo parti politike që paraqet kandidatë për deputetë, kandidatë për kryetarë bashkie ose komune, ose për këshilltarë në këshillin e bashkisë ose të komunës, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë Kod, regjistrohet në KQZ si subjekt zgjedhor jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Për t'u regjistruar pranë KQZ-së, një parti politike duhet të paraqesë:

- a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës;
- b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;
- c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;
- ç) kopjen e vulës së partisë;
- d) emrin dhe adresën e financierit të partisë;
- dh) emrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

Neni 13 **Regjistrimi i koalicioneve**

Dy ose më shumë parti politike mund të regjistrohen në KQZ si koalicion, duke paraqitur përbërjen e koalicionit dhe listat shumemërore të përbashkëta për Kuvendin ose këshillat vendorë.

KREU IV VËZHguesIT

Neni 14 **E drejta për të caktuar vëzhgues**

Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në çdo qendër votimi, si dhe pranë çdo komisioni zgjedhor.

Çdo shtetas shqiptar, që plotëson kushtet për të qenë zgjedhës, sipas këtij Kodi dhe që propozohet nga një subjekt i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ka të drejtë të jetë vëzhgues.

3. KQZ-ja miraton listat e vëzhguesve të paraqitura nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe pajis me autorizime të gjithë vëzhguesit, jo më vonë se 4 ditë para datës së votimit.

Neni 15 **Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve**

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:

- a) Të vëzhgojnë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve,
- b) Të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që

vërejnë.

Vëzhguesit kanë këto detyra:

Të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve.

b) Të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose alternativë referendare në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi.

c) Të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja.

ç) Të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit.

Të mos ndërhyjnë në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore.

PJESA TRETË KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

KREU I KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Neni 16 Cilësitë e anëtarëve

1. Anëtarët e KQZ-së duhet të kenë njohuri dhe përvojë profesionale në njërën nga këto fusha: të së drejtës, të administrimit të zgjedhjeve, të administratës publike ose të marrëdhënieve publike.

2. Anëtar i KQZ-së zgjidhet shtetasi shqiptar me vendbanim në Shqipëri, që plotëson këto kushte:

Gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Është me arsim të lartë.

c) Nuk është dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

ç) Nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të një partie politike gjatë tre vjetëve të fundit.

Neni 17 Zgjedhja e anëtarëve

Anëtarët e KQZ-së zgjidhen sipas nenit 154 të Kushtetutës. Anëtarët e KQZ-së kolegjisht duhet të përmbushin në çdo kohë kërkesat e pikës 1 të nenit 16 të këtij Kodi.

Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së pas konsultimeve me grupe që përfaqësojnë një spektër të gjerë të shoqërisë.

Kuvendi zgjedh dy anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve të Byrosë së Kuvendit, e cila harton dy lista me nga tre emra të propozuar nga grupet e opozitës dhe të shumicës parlamentare. Në rast se asnjëri nga kandidatët e një liste nuk fiton shumicën e nevojshme të votave, Byroja e Kuvendit paraqet një listë të re.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh me votim të fshehtë tre anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe të kandidaturave individuale; të gjitha propozimet dhe kandidaturat bëhen publike. Konferenca Gjyqësore Kombëtare propozon 6 juristë, të paktën njëri prej të cilëve zgjidhet anëtar i KQZ-së.

Pas zgjedhjes, anëtari i KQZ-së heq dorë menjëherë nga çdo veprimtari tjetër shtetërore ose politike.

Anëtarët e KQZ-së mund të rizgjidhen vetëm një herë.

Neni 18 Kompetencat

Në zbatim të nenit 153 të Kushtetutës, KQZ-ja kryen këto detyra:

Nxjerr, në zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës.

Merr vendime për njësimin e praktikave zgjedhore.

Drejton dhe kontrollon procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor.

Shpall me vendim rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në shkallë vendi, në bazë të rezultateve të shpallura nga KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja.

Shpall kandidatët fitues nga listat shumëmemërore për deputet.

Administron procesin e regjistrimit të zgjedhësve dhe mban Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

Zbaton programe për edukimin zgjedhor të shtetasve dhe për trajnimin e anëtarëve të komisioneve të zgjedhjeve.

Emëron dhe shkarkon, në përputhje me këtë Kod, anëtarët e KZZ-së, KZQV-së dhe të komisioneve zgjedhore të qarqeve dhe i mbikëqyr ato në përmbushjen e detyrave të tyre.

Në rast se në datën e zgjedhjeve për çdo arsye nuk arrihet kuorumi për zhvillimin e mbledhjeve të KZZ-së, KZQV-së ose KQV-së, KQZ-ja emëron menjëherë anëtarët e nevojshëm për plotësimin e kuorumit.

Boton buletinin e zgjedhjeve, i cili përmban rezultatet e zgjedhjeve për çdo njësi zgjedhore dhe qendër votimi, si dhe një raport mbi shpenzimet zgjedhore.

Paraqet në Kuvend, brenda muajit shkurt të çdo viti, një raport vjetor mbi veprimtaritë e vitit të kaluar.

Përgatit projektbuxhetin vjetor sipas ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”.

Administron fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme në shërbim të zgjedhjeve.

Shqyrton dhe zgjidh ankesat e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore për zhvillimin e procesit zgjedhor, në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

Cakton masën e shpërblimit për anëtarët dhe përfaqësuesit pa të drejtë vote të komisioneve zgjedhore.

Vendos sanksione administrative kundër personave që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet.

Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera.

Neni 19

Mbledhjet dhe vendimmarrja

Mbledhjet e KQZ-së janë të hapura, përveç mbledhjeve ku diskutohen çështje të personelit dhe hartimi i projektbuxhetit.

Mbledhjet e KQZ-së thirren bashkërisht nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së ose me kërkesën e të paktën 3 anëtarëve të saj. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, KQZ-ja qëndron e mbledhur sipas orarit të përcaktuar nga mbledhja e parë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve. Orari i mbledhjeve shpallet në një vend të dukshëm publik pranë KQZ-së dhe botohet në tri gazetatat me tirazhin më të madh.

Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të saj.

Aktet nënligjore, vendimi për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, vendimi për miratimin e listave të zgjedhësve dhe vendimi për t'i propozuar Kuvendit shkarkimin e një anëtari të KQZ-së miratohen kur votojnë “pro” katër anëtarë të KQZ-së. Të gjitha vendimet e tjera merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Aktet normative të KQZ-së marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

Vendimet e KQZ-së shpallen menjëherë, së bashku me mendimin e pakicës dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQZ-së që kanë votuar.

Shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve bëhet jo më vonë se tri ditë nga data kur KQZ-ja merr të gjitha të dhënat zyrtare nga komisionet zgjedhore ose vendimet e gjykatave në lidhje me ankimet kundër vendimeve të komisioneve zgjedhore. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së tij.

Neni 20
Imuniteti i anëtarëve

Anëtari i KQZ-së mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit.

Anëtari i KQZ-së mund të ndalohet ose arrestohet vetëm kur kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Në këto raste, organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të anëtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Neni 21
Paga

Paga e anëtarit të KQZ-së është e barabartë me pagën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së është 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit të KQZ-së.

Neni 22
Përfundimi i parakohshëm i mandatit

Mandati i anëtarit të KQZ-së përfundon para kohe kur:

dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

mungon në detyrë për më shumë se tre muaj jashtë periudhës së zgjedhjeve ose për më shumë se pesë ditë rresht gjatë periudhës së zgjedhjeve;

humbet të drejtën për të zgjedhur;

ç) jep dorëheqjen.

2. Në këto raste, Kryetari i KQZ-së njofton brenda 24 orëve organin që e ka zgjedhur anëtarin.

Neni 23
Shkarkimi i anëtarëve të KQZ-së

Anëtari i KQZ-së mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike që e pengojnë në përmbushjen e detyrës dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e anëtarit të KQZ-së.

Shkarkimi i anëtarit të KQZ-së propozohet nga një e pesta e deputetëve ose nga KQZ-ja, e cila vendos me shumicën e parashikuar në nenin 19 pika 4 të këtij Kodi.

Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 24
Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të KQZ-së

Anëtarët e KQZ-së marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e KQZ-së dhe kryejnë detyrat e parashikuara në këtë Kod dhe në aktet nënligjore të KQZ-së. Ata i ushtrojnë funksionet në cilësinë e tyre individuale dhe votojnë lirisht sipas bindjes së tyre të brendshme.

Neni 25
Përtëritja e përbërjes dhe zëvendësimi i anëtarëve

Në periudhën 1-31 mars 2003, njëri nga anëtarët e emëruar nga Presidenti, njëri nga anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi dhe njëri nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë zëvendësohen nga organet përkatëse.

Në periudhën 1-31 mars 2006, anëtari i dytë i emëruar nga Presidenti, anëtari i dytë i zgjedhur nga Kuvendi dhe njëri nga dy anëtarët e tjerë të zgjedhur fillimisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë zëvendësohen nga organet përkatëse.

Anëtarët që zëvendësohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, caktohen me short 30 ditë pas

hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Anëtari i tretë i zgjedhur fillimisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe anëtarët e rinj të zgjedhur sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zëvendësohen nga organet përkatëse në fund të mandatit të tyre shtatëvjeçar.

Anëtarët e rinj zgjidhen brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të mandatit të anëtarëve që largohen.

Në rast përfundimi të parakohshëm të mandatit të një anëtari, sipas nenit 22 ose 23 të këtij Kodi, organi që ka zgjedhur anëtarin që largohet emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës. Anëtari zëvendësues qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të plotë të anëtarit të larguar para kohe.

Pavarësisht nga pika 5 e këtij neni, përbërja e KQZ-së nuk mund të ndryshohet gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në këtë rast, anëtarët ekzistues zëvendësohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës së zgjedhjeve. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga organi përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda 48 orëve.

Kur vendi i Kryetarit ose Zëvendëskryetarit mbetet vakant, KQZ-ja zgjedh një kryetar ose zëvendëskryetar të ri brenda 15 ditëve. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, Kryetari ose Zëvendëskryetari zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda 48 orëve nga krijimi i vakancës.

Neni 26

Privilegjet pas mbarimit të mandatit

Pas përfundimit të mandatit, anëtari i KQZ-së përfiton të gjitha privilegjet që i takojnë një gjyqtari të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. Anëtari i KQZ-së nuk i përfiton këto privilegje kur mandati i tij përfundon para kohe, sipas shkronjave “a” ose “b” të pikës 1 të nenit 22 ose të nenit 23 të këtij Kodi, me përjashtim të rastit kur ai shkarkohet nga Kuvendi për paaftësi mendore ose fizike.

Neni 27

Kryetari i KQZ-së

KQZ-ja e zgjedh Kryetarin me votim të fshehtë nga radhët e anëtarëve të tij.

Anëtarët e KQZ-së votojnë për Kryetarin, duke zgjedhur në fletën e votimit njërin nga anëtarët.

Kryetar zgjidhet anëtari i KQZ-së që ka fituar shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Kur asnjëri prej anëtarëve nuk fiton shumicën e kërkuar, zhvillohet një raund i dytë votimi ndërmjet dy anëtarëve që kanë fituar më shumë vota në raundin e parë.

Kryetari zgjidhet për një periudhë trevjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Mandati i Kryetarit llogaritet brenda mandatit të tij si anëtar.

Neni 28

Detyrat e kryetarit

Kryetari i KQZ-së kryen këto detyra:

Kryeson mbledhjet e KQZ-së.

Përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.

Ushtron detyra të tjera të parashikuara në këtë Kod.

Neni 29

Zëvendëskryetari i KQZ-së

1. Zëvendëskryetari i KQZ-së zgjidhet me të njëjtën procedurë dhe afat si Kryetari i KQZ-së.
2. Zëvendëskryetari ushtron funksionet e Kryetarit në mungesë të tij.

Neni 30
Sekretari i KQZ-së

Sekretari i KQZ-së është nëpunësi më i lartë civil në administratën e KQZ-së dhe emërohet nga KQZ-ja mbi bazën e kandidaturave të përzgjedhura sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. Sekretari i KQZ-së duhet të jetë jurist me përvojë në administrimin e zgjedhjeve ose në administratën publike për jo më pak se pesë vjet dhe duhet të plotësojë kushtet për të qenë anëtar i KQZ-së.

Sekretari i KQZ-së kryen këto detyra:

Bashkërendon veprimtarinë e KQZ-së me organet kompetente dhe ndjek zbatimin e vendimeve të KQZ-së.

Organizon procedurën e zgjedhjes së Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të KQZ-së.

Merr masa për zhvillimin e rregullt të mbledhjeve të KQZ-së.

ç) Merr masa për botimin e akteve normative të KQZ-së në Fletoren Zyrtare.

Mbikëqyr arkivimin dhe ruajtjen e vendimeve të KQZ-së në një regjistër publik.

dh) Drejton administratën e KQZ-së.

Kryen detyra të tjera të caktuara nga KQZ-ja.

3. Sekretari shkarkohet nga KQZ-ja në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”.

Neni 31
Përfaqësuesit e partive politike

Çdo parti politike ose koalicion i regjistruar në KQZ mund të caktojë vetëm një përfaqësues pa të drejtë vote në KQZ.

Përfaqësuesit e partive politike në KQZ kanë këto të drejta:

Të ndjekin mbledhjet e hapura të KQZ-së, të marrin fjalën në këto mbledhje dhe të vëzhgojnë veprimtarinë e KQZ-së për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve.

Të japin mendime me shkrim për çështjet që shqyrtohen nga KQZ-ja dhe të paraqesin ankesa në KQZ për shkelje të këtij Kodi dhe të akteve nënligjore të KQZ-së.

Të marrin kopje të vendimeve dhe të akteve të tjera të KQZ-së, si dhe të njihen me dokumentacionin e zgjedhjeve nëpërmjet Sekretarit të KQZ-së.

ç) Të marrin përgjigje me shkrim për ankesat e tyre.

3. Përfaqësuesit i ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me rregulloren e brendshme të KQZ-së dhe, në çdo rast, pa penguar funksionimin normal të KQZ-së.

KREU II
KOMISIONET E ZONAVE ZGJEDHORE (KZZ)

Neni 32
Përbërja e KZZ-së

1. KZZ-ja përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të emëruar nga KQZ-ja me propozimin e shtatë partive politike që kanë fituar më shumë vota në zonën përkatëse në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Kryetari dhe zëvendëskryetari caktohen përkatësisht nga dy partitë e para që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e fundit në zonën përkatëse.

2. Në rast se më pak se shtatë parti kanë fituar vota në zonën përkatëse në zgjedhjet e fundit për Kuvendin, KZZ-ja formohet vetëm nga përfaqësuesit e atyre partive që kanë fituar vota.

3. Sekretari i KZZ-së emërohet nga KQZ-ja, me propozim të KZZ-së, për një periudhë kohe që caktohet nga KQZ-ja. Sekretari i KZZ-së duhet të jetë jurist dhe ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote të KZZ-së.

4. Anëtarët e KZZ-së nuk mund të jenë deputetë ose kandidatë për Kuvend, në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore ose anëtarë të më shumë se një KZZ-je. Anëtarët e KZZ-së nuk mund të jenë ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ të Shtetit.

5. Anëtarët e KZZ-së duhet të jenë me arsim të lartë dhe nuk duhet të jenë dënuar për kryerjen

e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Anëtarët e KZZ-së duhet të jenë me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse.

7. KZZ-ja është organ i përhershëm, por anëtarët e tij nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së anëtarëve të KZZ-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj.

8. Çdo parti politike e regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, e cila nuk ka anëtar në KZZ sipas pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë të caktojë një përfaqësues pa të drejtë vote në KZZ pas caktimit të një kandidati për zonën njëemërore ose të kandidatëve të listës shumëemërore.

9. Kandidatët e pavarur të zonës përkatëse kanë të drejtë të emërojnë nga një përfaqësues pa të drejtë vote në KZZ.

10. Në qoftë se një parti politike me anëtar në KZZ nuk cakton kandidat në atë zonë dhe nuk ka paraqitur listë shumëemërore për zgjedhjet përkatëse, ajo parti e humbet vendin e saj në KZZ.

11. KZZ-ja ringrihet në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin jo më vonë se një muaj pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja.

12. Kur vendi i një anëtari të KZZ-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen brenda 30 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda 3 ditëve.

Neni 33

Përfaqësuesit pa të drejtë vote

Përfaqësuesit pa të drejtë vote në KZZ pajisen me autorizim nga partia ose kandidati i pavarur.

Përfaqësuesit në KZZ kanë të gjitha të drejtat që gëzojnë përfaqësuesit e partive në KQZ sipas pikës 2 të nenit 31 të këtij Kodi.

Neni 34

Shkarkimi i anëtarëve të KZZ-së

Anëtarët e KZZ-së shkarkohen nga KQZ-ja për të njëjtat shkaqe që çojnë në shkarkimin e anëtarëve të KQZ-së.

Neni 35

Detyrat e KZZ-së

KZZ-ja përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin brenda zonës zgjedhore përkatëse dhe kryen këto detyra:

1. Përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve në zonë sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja.

2. Cakton kufijtë e zonave të qendrave të votimit në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.

3. Përcakton vendndodhjen e çdo qendre votimi dhe i cakton secilës prej tyre një numër.

4. Emëron kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e KQV-ve sipas këtij Kodi.

5. Verifikon dokumentacionin e kandidatëve.

6. Shqyrton ankesat e partive politike në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë.

7. Shpall në një vend të dukshëm listat e zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë.

8. Administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja për zgjedhjet në zonë.

9. Garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit.

10. Merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit.

11. Përgatit tabelën e rezultateve të zgjedhjeve në zonë dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 107 të këtij Kodi.

12. Shpall rezultatet e zgjedhjeve në zonë.

13. Administron zgjedhjet e pjesshme në zonë.

14. Organizon rinumërimin e votave.

Neni 36

Mbledhjet dhe vendimet e KZZ-së

1. Mbledhjet e KZZ-së janë të hapura, përveç sa parashikohet në nenin 107 të këtij Kodi.
2. Vendimet në KZZ merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të KZZ-së
3. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë votuar. Vendimet shoqërohen me mendimin e pakicës.

Neni 37

Veprimet e KZZ-së pas daljes së dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve të Kuvendit

Pas daljes së dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, KZZ-ja e publikon atë menjëherë në shtypin dhe mediat elektronike vendore, në zyrat e bashkisë ose të komunës dhe në zyrat e gjendjes civile të zonës. Së bashku me dekretin, KZZ-ja publikon edhe vendndodhjen e të gjitha qendrave të votimit në zonë, orarin e votimit, emrat e të gjithë anëtarëve të KZZ-së dhe sekretarit të saj, adresën e zyrës së komisionit, numrin e telefonit dhe të faksit, si dhe një hartë të zonës zgjedhore me të gjitha qendrat e votimit. KZZ-ja publikon çdo dokumentacion tjetër, që në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, duhet të bëhet publik.

KREU III

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR QEVERISJEN VENDORE (KZQV)

Neni 38

Përbërja e KZQV-së

1. Pranë çdo bashkie dhe komune ngrihet një KZQV, e cila përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të emëruar nga KQZ-ja me propozimin e shtatë partive politike që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit për këshillin vendor përkatës. Kryetari dhe zëvendëskryetari caktohen përkatësisht nga dy partitë e para që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e fundit për këshillin e bashkisë ose të komunës përkatëse.
2. Në rast se më pak se shtatë parti kanë fituar vota në zgjedhjet e fundit për këshillin përkatës, KZQV-ja formohet vetëm nga përfaqësuesit e atyre partive që kanë fituar vota.
3. Sekretari i bashkisë ose i komunës shërben si sekretar i KZQV-së për një periudhë kohe që caktohet nga KQZ-ja. Sekretari ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote të KZQV-së.
4. Anëtarët e KZQV-së nuk mund të jenë deputetë ose kandidatë për Kuvend, në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore ose anëtarë të një KZQV-je tjetër. Anëtarët e KZQV-së nuk mund të jenë ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ të Shtetit.
5. Anëtarët e KZQV-së, si rregull, duhet të jenë me arsim të lartë dhe nuk duhet të jenë dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.
6. Anëtarët e KZQV-së duhet të jenë me vendbanim në njësinë vendore përkatëse.
7. KZQV-ja është organ i përhershëm, por anëtarët e tij nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja cakton orarin e punës së anëtarëve të KZQV-së gjatë periudhës së zgjedhjeve ose jashtë saj.
8. Partitë politike të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore, të cilat nuk kanë anëtarë në KZQV sipas pikës 1 të këtij neni, kanë të drejtë të caktojnë nga një përfaqësues pa të drejtë vote në KZQV pas paraqitjes së kandidatit për kryetar bashkie ose komune, ose të kandidatëve të listës shumëmemërore për këshillin vendor.
9. Kandidatët e pavarur të komunës ose bashkisë kanë të drejtë të emërojnë nga një përfaqësues pa të drejtë vote në KZQV.
10. Në qoftë se një parti politike me anëtar në KZQV nuk cakton kandidat për kryetar bashkie ose komune ose nuk ka paraqitur listë shumëmemërore për këshillin vendor, ajo e humbet vendin në KZQV.
11. KZQV-ja ringrihet në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për këshillin vendor jo më vonë se një muaj pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve vendore nga KQZ-ja.
12. Kur vendi i një anëtari të KZQV-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat

e parashikuara në këtë nen brenda 30 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve vendet vakante plotësohen brenda tri ditëve.

Neni 39

Përfaqësuesit pa të drejtë vote

Përfaqësuesit pa të drejtë vote në KZQV pajisen me autorizim nga partia ose kandidati i pavarur.

Përfaqësuesit në KZQV kanë të gjitha të drejtat që gëzojnë përfaqësuesit e partive në KQZ sipas pikës 2 të nenit 31 të këtij Kodi.

Neni 40

Shkarkimi i anëtarëve të KZQV-së

Anëtarët e KZQV-së shkarkohen nga KQZ-ja për të njëjtat arsye që çojnë në shkarkimin e anëtarit të KQZ-së.

Neni 41

Detyrat e KZQV-së

KZQV-ja kryen këto detyra:

1. Përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore; përgjigjet për shpalljen, rishikimin dhe miratimin e listave paraprake të zgjedhësve të bashkisë ose të komunës përkatëse, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe udhëzimeve të KQZ-së.

2. Cakton kufijtë e zonave të qendrave të votimit të bashkisë ose të komunës në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.

3. Zbaton për analogji detyrat që parashikohen në këtë Kod për KZZ-në.

4. Në zgjedhjet për Kuvendin, i dorëzon KZZ-së listën e rishikuar të zgjedhësve.

Neni 42

Mbledhjet dhe vendimet e KZQV-së

Mbledhjet e KZQV-së janë të hapura, përveç sa parashikohet në nenin 107 të këtij Kodi.

Vendimet në KZQV merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të KZQV-së.

Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë votuar. Vendimet shoqërohen me mendimin e pakicës.

KREU IV

KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 43

Përbërja e KQV-së

Për çdo zonë të qendrës së votimit ngrihet një KQV, e cila përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të propozuar nga shtatë partitë politike që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit për Kuvendin në zonën përkatëse njëemërore ose në zgjedhjet e fundit për këshillin vendor përkatës. Kryetari dhe zëvendëskryetari caktohen përkatësisht nga dy partitë e para që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit në njësinë përkatëse zgjedhore.

Në rast se më pak se shtatë parti kanë fituar vota në zgjedhjet e fundit, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, KQV-ja formohet vetëm nga përfaqësuesit e atyre partive që kanë fituar vota.

Sekretari i KQV-së emërohet nga KZZ-ja ose, sipas rastit, nga KZQV-ja. Sekretari ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote të KQV-së.

Anëtarët e KQV-së nuk mund të jenë deputetë ose kandidatë për Kuvend ose në organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore ose anëtarë të një KQV-je tjetër. Anëtarët e KQV-së nuk mund të jenë

ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Anëtarët e KQV-së nuk duhet të jenë dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Anëtarët e KQV-së duhet të jenë me vendbanim në zonën e qendrës së votimit përkatëse.

Anëtarët e KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Në çdo rast, emërimi i tyre bëhet jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

Partitë politike të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore, të cilat nuk kanë anëtarë në KQV sipas pikës 1 të këtij neni, kanë të drejtë të caktojnë nga një përfaqësues pa të drejtë vote, të cilët gëzojnë të drejtat e parashikuara në pjesën e shtatë të këtij Kodi.

Kandidatët e pavarur kanë të drejtë të emërojnë nga një përfaqësues pa të drejtë vote në KQV.

Kur vendi i një anëtari të KQV-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen, brenda 30 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda tri ditëve.

Neni 44

Detyrat e KQV-së

KQV-të ngrihen dhe funksionojnë për të gjitha llojet e zgjedhjeve.

Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në këtë Kod.

Neni 45

Vendimmarrja në KQV

1. Vendimet në KQV merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të KQV-së.

2. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë votuar. Vendimet shoqërohen me mendimin e pakicës.

Neni 46

Materialet e votimit

KQZ-ja i pajis KZZ-të dhe KZQV-të me materialet e nevojshme për çdo qendër votimi jo më vonë se shtatë ditë para datës së zgjedhjeve.

KZZ-të, KZQV-të dhe KQV-të i ruajnë materialet e zgjedhjeve në një vend të sigurtë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.

KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja ua shpërndan materialet e zgjedhjeve kryetarëve dhe sekretarëve të KQV-ve jo më shpejt se 48 orë dhe jo më vonë se 24 orë para hapjes së qendrës së votimit.

Nje kopje e aktit të marrjes në dorëzim të materialeve mbahet në procesverbalin e qendrës së votimit.

KREU V

KQV TË POSAÇME

Neni 47

Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-ve të posaçme

KZZ-ja ose sipas rastit KZQV-ja krijon, në përputhje me këtë Kod dhe udhëzimet e KQZ-së, KQV të posaçme në spitale, burgje, vende paraburgimi ose konvikte. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja.

PJESA E KATËRT
REGJISTRI KOMBËTAR I ZGJEDHËSVE

KREU I
ORGANET KOMPETENTE

Neni 48

Organi kompetent

Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve përgatitet nën mbikëqyrjen e KQZ-së. Ai përmban të dhëna dhe përgatitet në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, si dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja në zbatim të tij.

Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve përgatitet në bazë të të dhënave zyrtare, të nxjerra nga regjistrat e gjendjes civile.

Neni 49

Drejtoria e Regjistrimit të Zgjedhësve

Për administrimin e Regjistrit Kombëtar të Zgjedhësve, KQZ-ja krijon Drejtorinë e Regjistrimit të Zgjedhësve.

Drejtoria e Regjistrimit të Zgjedhësve përgjigjet për zbatimin e vendimeve të KQZ-së në lidhje me regjistrimin e zgjedhësve. Ajo kryen këto detyra:

Administron Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

Përgatit për KQZ-në udhëzime për zyrat e gjendjes civile për mënyrën e hartimit të listave të zgjedhësve.

Organizon dhe drejton regjistrimin e zgjedhësve shtëpi më shtëpi sa herë që gjykohet e nevojshme.

ç) Kryen detyra të tjera në lidhje me regjistrimin e zgjedhësve, të caktuara nga KQZ-ja.

Neni 50

Karta e zgjedhësit

Çdo zgjedhës i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve pajiset me kartën e zgjedhësit, sipas udhëzimeve të KQZ-së.

Karta e zgjedhësit tërhiqet vetëm nga zgjedhësi personalisht.

Karta e zgjedhësit përmban fotografinë e tij dhe një numër unik identifikimi.

Kur karta e zgjedhësit humbet ose bëhet e papërdorshme, zgjedhësi pajiset me kartë të re, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

KREU II
PËRGATITJA E LISTAVE TË ZGJEDHËSVE

Neni 51

Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve

Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve përbëhet nga listat e zgjedhësve të të gjitha bashkive dhe komunave.

Neni 52

Regjistrimi sipas vendbanimit ose vendqendrimit

Zgjedhësit regjistrohen në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Zgjedhësit që banojnë larg vendbanimit të tyre, por brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, regjistrohen në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendqendrimit të tyre,

duke u çregjistruar nga lista e zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tyre.

KZQV-ja e vendqendrimin të zgjedhësit e regjistron atë në listën paraprake të zgjedhësve të zonës së qendrës përkatëse të votimit dhe njofton KQZ-në, e cila urdhëron çregjistrimin e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tij.

Neni 53

Listat paraprake të zgjedhësve

Listat paraprake të zgjedhësve nxirren nga regjistrat e gjendjes civile.

Listat e zgjedhësve përmbajnë:

emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, adresën dhe numrin e kartës së zgjedhësit;

emrin e komunës ose të bashkisë, ose numrin e zonës zgjedhore, si dhe numrin e qendrës së votimit.

Neni 54

Rishikimi i listave paraprake

KQZ-ja, katër muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organeve të qeverisjes vendore, i kërkon Zyrës Kombëtare të Gjendjes Civile të hartojë, brenda dy javëve, listat paraprake të zgjedhësve, sipas llojit të zgjedhjeve që do të zhvillohen. KQZ-ja i dërgon menjëherë çdo KZQV-je katër kopje të listave paraprake të zgjedhësve.

KZQV-ja i shpall menjëherë listat paraprake në një vend publik, duke bërë njoftimin përkatës për datat dhe orarin e pranimit të ankesave të zgjedhësve. Çdo zgjedhës ose parti politike ka të drejtë të kërkojë nga KZQV-ja korrigjimin e pasaktësive në listat paraprake të zgjedhësve, në përputhje me kushtet e nenit 12 të Kodit Civil dhe të neneve 55 deri 58 të këtij Kodi.

Kur e çmon të nevojshme dhe me miratimin e KQZ-së, KZQV-ja ngre grupe verifikimi shtëpi më shtëpi, të cilat kanë për detyrë të verifikojnë saktësinë e të dhënave në lista. Kur vërejnë pasaktësi, grupet e verifikimit plotësojnë formularët përkatës dhe i dorëzojnë në KZQV.

KQZ-ja përcakton rregullat për përbërjen e grupeve të verifikimit dhe për kryerjen e verifikimit.

Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin, zgjedhjet e pjesshme dhe referendumet, procedurat e parashikuara në pikat 1 deri 4 të këtij neni zbatohen në përputhje me afatet ligjore, për aq sa është e mundur, dhe në përshtatje me rrethanat.

Neni 55

Shkaqet për ndryshime në listat paraprake

Listat e zgjedhësve ndryshohen kur një zgjedhës:

vdes;

ka humbur të drejtën për të zgjedhur;

është regjistruar në më shumë se një listë;

ç) ka ndryshuar vendbanim ose vendqendrim;

d) provon se të dhënat e tij vetjake në lista nuk janë të sakta.

2. Në rastin e shkronjës “ç” të pikës 1, zgjedhësi regjistrohet në listën përkatëse të zgjedhësve, sipas udhëzimeve të KQZ-së.

Neni 56

Ndalimi i ndryshimit të listave

KZQV-ja nuk mund të bëjë ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve gjatë 23 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve.

Neni 57

Shpallja e listave përfundimtare

Pas përfundimit të periudhës së rishikimit të listave paraprahe, çdo KZQV ia dërgon KQZ-së brenda 24 orëve listën e rishikuar të njësisë së tij zgjedhore.

KQZ-ja i përfshin listat e rishikuara në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve. Drejtoria e Regjistrimit të Zgjedhësve i dërgon listat përfundimtare në KZZ ose, sipas rastit, në KZQV, ose në komisionet të tjera që parashikon ky Kod, jo më vonë se dy javë para datës së zgjedhjeve.

Komisionet përkatëse i shpallin listat përfundimtare brenda 48 orëve nga data e marrjes së tyre nga KQZ-ja.

KZZ-ja ose KZQV-ja i dërgon listat përfundimtare në KQV jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve. KZZ-ja dhe KZQV-ja mbajnë një kopje të listave përfundimtare të zgjedhësve.

Neni 58

Vënia e listave në dispozicion të subjekteve zgjedhore

KQZ-ja vë në dispozicion të çdo partie politike të regjistruar, me kërkesën e saj dhe përkundrejt pagesës, një kopje të listave paraprahe të zgjedhësve të përgatitura sipas nenit 54 të këtij Kodi.

Pas përfundimit të afatit për regjistrimin e kandidatëve, KZZ-ja, ose sipas rastit, KZQV-ja, vë në dispozicion të çdo subjekti zgjedhor, me kërkesën e tij dhe përkundrejt pagesës, një kopje të listave të rishikuara që i dërgohen KQZ-së sipas pikës 1 të nenit 57 të këtij Kodi.

Pas miratimit të listave përfundimtare të zgjedhësve, KQZ-ja u vë në dispozicion zyrave qendrore të çdo partie politike të regjistruar nga një kopje të listave, me kërkesën e saj.

Kandidatët dhe partitë i përdorin listat e zgjedhësve vetëm për të verifikuar saktësinë e tyre dhe në përputhje me ligjin.

KQZ-ja cakton mënyrën e vënies së listave në dispozicion të subjekteve zgjedhore, si dhe tarifat përkatëse.

Neni 59

Institucionet e posaçme

Për zgjedhjet dhe referendumet e përgjithshme, dy ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit të posaçëm përgatit listën e zgjedhësve dhe ia dorëzon atë KZZ-së.

Për zgjedhjet dhe referendumet vendore, dy ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit të posaçëm përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë KZQV-së.

Neni 60

Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit

Menjëherë pas caktimit të datës së zgjedhjeve për Kuvendin, Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera qendrore kompetente, me kërkesë të KQZ-së, urdhërojnë komandantët e reparteve përkatëse të përgatisin listën e zgjedhësve që do të ndodhen në ato reparte në datën e zgjedhjeve.

Lista e zgjedhësve, që do të ndodhen në repartet ushtarake ose të rendit në datën e zgjedhjeve, i dorëzohet KZZ-së jo më vonë se 15 ditë pas caktimit të datës së zgjedhjeve.

KZZ-ja ia bashkëngjit listën e zgjedhësve, me vendqendrim në repartet ushtarake ose të rendit listës së zgjedhësve për njësinë zgjedhore përkatëse. Këta hiqen nga listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre në përputhje me procedurat e caktuara nga KQZ-ja.

Neni 61

Studentët

Studentët kanë të drejtë të votojnë në vendqendrimin e tyre në përputhje me aktet nënligjore të KQZ-së. KQZ-ja merr masa që studentët të mos regjistrohen në më shumë se një listë zgjedhësish.

PJESA E PESTË
SISTEMI I ZGJEDHJEVE

KREU I
SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Neni 62

Përbërja e Kuvendit

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhësit në zonat zgjedhore njëemërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara në raundin e parë të zgjedhjeve nga listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore të depozituara në KQZ.

Neni 63

Zgjedhja e deputetit në zonat njëemërore

Quhet i zgjedhur deputet në Kuvend në zonën njëemërore kandidati që fiton shumicën absolute të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim në atë zonë.

Në qoftë se në raundin e parë të zgjedhjeve asnjëri nga kandidatët nuk fiton shumicën absolute, atëherë pas dy javësh zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve. Në raundin e dytë të zgjedhjeve marrin pjesë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave në raundin e parë.

Në qoftë se një kandidat tërhiqet nga raundi i dytë, në vend të tij merr pjesë në raundin e dytë kandidati që ka fituar më shumë vota në raport me kandidatët e tjerë.

Në rastin kur tre ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash në raundin e parë, atëherë dy kandidatët që marrin pjesë në raundin e dytë caktohen me short. Në të njëjtën mënyrë veprohet për të zgjedhur kandidatin e dytë, kur njëri është i përcaktuar dhe të tjerët janë me numër të barabartë votash.

KZZ-ja, pas konstatimit të nevojës për një raund të dytë zgjedhjesh, shpall kandidatët për të cilët votohet në këtë raund. Shpallja bëhet në të njëjtën kohë me nxjerrjen e rezultatit të votimit në zonë.

Neni 64

Votimi në raundin e dytë

Në raundin e dytë të zgjedhjeve quhet i zgjedhur deputet në Kuvend kandidati që ka fituar shumicën e votave të vlefshme.

Në rast se, edhe pas raundit të dytë të zgjedhjeve, kandidatët kanë fituar një numër të barabartë votash, atëherë deputet i zonës zgjidhet me short njëri prej kandidatëve.

KQZ-ja organizon, sa herë që të jetë e nevojshme, procedurat e shortit. Shorti organizohet në prani të kandidatëve.

Neni 65

Kandidatët e përbashkët

Partitë politike të regjistruara në KQZ kanë të drejtë të paraqesin kandidatë të përbashkët për deputet.

Koalicionet e partive politike të regjistruara në KQZ mund të paraqesin listë shumëemërore të përbashkët të kandidatëve.

Paraqitja e kandidatëve të përbashkët, si dhe e listave shumëemërore të përbashkëta bëhet sipas afateve të parashikuara në nenin 76 të këtij Kodi.

Ndarja e mandateve plotësuese

Dyzet mandatet plotësuese ndahen midis partive dhe koalicioneve të partive, sipas rregullave të mëposhtme:

a) Partitë që fitojnë më pak se 2.5 për qind dhe koalicionet e partive që fitojnë më pak se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve nuk përfitojnë nga mandatet plotësuese.

b) Numri i votave të vlefshme të fituara nga çdo parti ose koalicion, që kalon pragun përkatës, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në shkallë vendi dhe rezultati shumëzohet me 140. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve i caktohet fillimisht një numër i përgjithshëm mandatesh, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

c) Për të përcaktuar numrin e mandateve plotësuese, që përfiton çdo parti ose koalicion, nga numri i mandateve të caktuara sipas shkronjës “b” të këtij neni, zbritet numri i mandateve të fituara nga çdo parti ose koalicion në zonat njëemërore. Në rast se diferenca është negative ose zero, partia ose koalicioni përkatës mban vetëm mandatet e fituara në zonat njëemërore.

ç) Pavarësisht nga shkronja “b”, në rast se:

i) në një ose më shumë zona njëemërore fitojnë kandidatët e pavarur;

ii) në një ose më shumë zona njëemërore fitojnë kandidatët e partive ose të koalicioneve që nuk e kalojnë pragun përkatës; ose

iii) partitë ose koalicionet që kalojnë pragun përkatës fitojnë më shumë mandate në zonat njëemërore se sa do t’u takonin në bazë të shkronjës “b”,

ndarja e mandateve plotësuese mes partive dhe koalicioneve, për të cilat diferenca e parashikuar në shkronjën “c” është pozitive, bëhet në bazë të formulës së mëposhtme:

$$N = (A - B) [40/(40 + C)],$$
 ku N është numri i mandateve plotësuese që përfiton partia ose koalicioni, A është numri i mandateve që i caktohet partisë ose koalicionit sipas shkronjës “b”, B është numri i mandateve të fituara prej tyre në zonat njëemërore dhe C është shuma e mandateve të fituara, sipas pikave “i”, “ii” dhe “iii” të kësaj shkronje (në rastin e pikës “iii”, mbledhet vetëm teprica). Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve i caktohet fillimisht një numër mandatesh plotësuese, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

d) Në qoftë se një kandidat i përbashkët i dy apo më shumë partive, që nuk janë në koalicion, zgjidhet deputet i një zone njëemërore, për efekt të llogaritjeve të shkronjës “c” konsiderohet se mandatin e tij e ka fituar ajo parti që ka fituar më shumë vota në shkallë vendi në raundin e parë, përveç kur partitë kanë rënë dakord ndryshe.

dh) Deputetët zgjidhen nga listat shumëemërore të partive ose koalicioneve, sipas renditjes në to.

e) Në rast se numri i kandidatëve në listën shumëemërore të një partie politike ose koalicioni është më i vogël se numri i vendeve që i takojnë asaj partie ose koalicioni, sipas këtij neni, vendet e paplotësuara ndahen midis partive dhe koalicioneve të tjera të partive që kalojnë pragun përkatës në përputhje me formulën e mëposhtme:

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga secila nga partitë ose koalicionet e mësipërme, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve të paplotësuara. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve fillimisht i caktohet një numër vendesh shtesë i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Vendet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetje dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për vendin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

Neni 67
Zonat zgjedhore njëmërore

Për efekt të zgjedhjeve për Kuvendin, territori i Republikës ndahet në 100 zona zgjedhore njëmërore.

Kufijtë e zonave zgjedhore nuk mund të ndryshohen gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit.

Neni 68
Komisioni i Kufijve të Zonave Zgjedhore

Zonat zgjedhore caktohen me ligj nga Kuvendi në bazë të rekomandimeve të Komisionit të Kufijve të Zonave Zgjedhore.

Komisioni i Kufijve të Zonave Zgjedhore (Komisioni) mbledhet çdo pesë vjet, duke filluar nga data 1 gusht 2000, për të rishikuar ndarjen e zonave zgjedhore, sipas kritereve të parashikuara në këtë Kod.

Komisioni përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Sekretari i KQZ-së.

Drejtori i Institutit të Statistikave.

Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme.

ç) Drejtori i Qendrës së Studimeve Gjeografike të Akademisë së Shkencave.

4. Kryetari i KQZ-së thërret mbledhjen e parë të Komisionit, pas të cilës Sekretari i KQZ-së shërben si Kryetar i Komisionit.

KQZ-ja cakton buxhetin dhe shërbimet ndihmëse administrative për Komisionin.

Neni 69
Procedurat për caktimin e zonave zgjedhore

Brenda 3 muajve nga mbledhja e tij, Komisioni harton një raport paraprak me rekomandimet fillestare për caktimin e zonave. Raporti paraprak vihet në dispozicion të partive politike, të shtypit dhe të çdo pale tjetër të interesuar që kërkon një kopje.

Duke filluar 2 javë pas përfundimit të raportit paraprak, Komisioni zhvillon një seri mbledhjesh të hapura, ku partitë politike dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë të bëjnë vërejtje në lidhje me përmbajtjen e raportit paraprak.

Komisioni i rishqyrton rekomandimet e tij paraprake, duke marrë parasysh vërejtjet e bëra në mbledhjet e hapura dhe i paraqet Kuvendit raportin përfundimtar për caktimin e zonave zgjedhore jo më vonë se të hënën e parë të dhjetorit të vitit përkatës.

Neni 70
Raportet e Komisionit

Raporti paraprak dhe ai përfundimtar përmbajnë numrin mesatar të zgjedhësve për zonë, numrin e zgjedhësve të çdo zone, si dhe diferencën midis këtyre dy numrave për çdo zonë; hartën e çdo zone zgjedhore; listën e bashkive dhe të komunave që përfshihen në çdo zonë; si dhe një përshkrim të kufijve të çdo zone zgjedhore.

Raporti përfundimtar përmban edhe një përmbledhje të vërejtjeve të bëra në mbledhjet e hapura, së bashku me vendimet e Komisionit në lidhje me to.

Neni 71
Kriteret për caktimin e kufijve të zonave

Komisioni i cakton kufijtë e zonave zgjedhore sipas procedurave të mëposhtme:

Merr nga KQZ-ja numrin e përgjithshëm të zgjedhësve, si dhe numrin e zgjedhësve në çdo njësi zgjedhore dhe zonë qendre votimi ekzistuese. Këto të dhëna nxirren nga Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve ashtu si rezultojnë në datën 1 gusht të vitit përkatës.

Merr nga KQZ-ja dhe burime të tjera kompetente hartat e zonave zgjedhore, të bashkive dhe komunave dhe të zonave të qendrave të votimit ekzistuese, si dhe harta të tjera që i çmon të nevojshme.

Përcakton numrin mesatar të zgjedhësve për zonë, duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve me numrin e zonave zgjedhore njëemërore.

Përcakton diferencën në përqindje mes numrit mesatar të zgjedhësve dhe numrit të zgjedhësve të çdo zone.

Rishikon kufijtë e të gjitha zonave në mënyrë që diferenca mes numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar të jetë, për aq sa është e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 për qind të numrit mesatar.

Kur numri i zgjedhësve në një bashki është brenda intervalit plus ose minus 5 për qind të numrit mesatar, ajo bashki duhet të përbëjë një zonë zgjedhore.

Për aq sa është e mundur, komuna duhet të përfshihet tërësisht brenda një zone zgjedhore, dhe bashkia me numër zgjedhësish më të vogël se ai që parashikohet në pikën 6 të këtij neni nuk duhet të ndahet në më shumë se dy zona zgjedhore.

Përveç rregullit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni, Komisioni merr parasysh edhe kriteret e mëposhtme për caktimin e kufijve të zonave zgjedhore:

- a) Lidhjet tradicionale dhe interesat e përbashkët të bashkësive vendore.
- b) Kufijtë dhe barrierat natyrore.
- c) Linjat e transportit dhe të komunikimit.
- ç) Kufijtë e qarqeve.

Zonat zgjedhore duhet të jenë kompakte dhe nuk mund të ndahen në pjesë të shkëputura nga njëra-tjetra.

Neni 72

Shqyrtimi i raportit përfundimtar

Kuvendi e shqyrton raportin përfundimtar të Komisionit brenda dy javëve nga marrja e tij. Kuvendi e pranon raportin dhe miraton ligjin për zonat zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e raportit përfundimtar ose ia kthen raportin Komisionit për rishqyrtim. Kuvendi nuk mund të ndryshojë kufijtë e zonave të rekomanduara nga Komisioni.

Në rast se Kuvendi ia kthen raportin Komisionit për rishqyrtim, Komisioni rishikon rekomandimet e bëra dhe i paraqet Kuvendit brenda 30 ditëve një raport të rishikuar. Kuvendi e shqyrton raportin e ri brenda 15 ditëve.

Neni 73

Hyrja në fuqi e kufijve të rinj të zonave

Ligji për zonat zgjedhore hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve më të afërta, me përjashtim të rastit kur zbatohet pika 3 e këtij neni.

Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, KQZ-ja mund t'i ushtrojë funksionet sipas kufijve të rinj të parashikuar në ligjin për zonat zgjedhore pas hyrjes së tij në fuqi.

Në rast se Kuvendi nuk e miraton ligjin për zonat zgjedhore para 6 muajve të fundit të mandatit të tij, zgjedhjet më të afërta për Kuvendin zhvillohen në bazë të zonave ekzistuese.

Në rast se pas fillimit të rishikimit të kufijve të zonave shpallet data e zgjedhjeve për Kuvendin ose data e zgjedhjeve vendore, Komisioni vazhdon punën, por nuk mund të zhvillojë mbledhje të hapura ose ta bëjë publik raportin paraprak, deri pas shpalljes zyrtare të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

Në periudhën midis miratimit të ligjit të ri për zonat zgjedhore dhe zgjedhjeve të reja për Kuvendin, zgjedhjet e pjesshme zhvillohen sipas zonave ekzistuese në kohën e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin.

KREU III SISTEMI I ZGJEDHJEVE VENDORE

Neni 74

Sistemi i zgjedhjeve vendore

Kryetarët e bashkive ose të komunave, si dhe anëtarët e këshillave të bashkive ose komunave, zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës.

Anëtarët e këshillave të bashkisë dhe të komunave zgjidhen në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike dhe koalicionet, si dhe në bazë të kandidaturave të pavarura individuale.

Partitë politike të regjistruara në KQZ, kanë të drejtë të paraqesin kandidat të përbashkët për kryetarë bashkie ose komune, si dhe lista të përbashkëta shumemërore për këshillat vendorë.

Neni 75

Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore

Kryetar bashkie ose komune zgjidhet kandidati që fiton më shumë se gjysmën e të gjitha votave të vlefshme. Në qoftë se asnjë kandidat nuk fiton shumicën e kërkuar, organizohet një raund i dytë votimi, duke zbatuar për analogji nenet 63 dhe 64 të këtij Kodi.

Mandatet e këshillave vendore ndahen nga KZQV-ja në bazë të sistemit proporcional të mëposhtëm:

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga çdo kandidat i pavarur, pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme dhe shumëzohet me numrin e vendeve në këshill. Në rast se rezultati është 1 ose më i madh se 1, kandidati i pavarur fiton një vend në këshill.

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga çdo parti ose koalicion, si dhe nga çdo kandidat i pavarur që nuk ka fituar një vend në këshill, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve që mbeten pasi zbatohet shkronja “a” e pikës 2 të këtij neni. Secili prej këtyre subjekteve zgjedhore përfiton një numër vendesh të barabartë me numrin e plotë që rezulton nga llogaritja e mësipërme. Në rast se për kandidatin e pavarur rezultati është 1 ose më i madh se 1, kandidati i pavarur fiton vetëm 1 vend. Vendet që mbeten u jepen subjekteve zgjedhore me mbetjet dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

Kandidatët e partive ose të koalicioneve zgjidhen me këshillat vendorë sipas radhës në listat shumemërore përkatëse.

d) Në rast se numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie ose koalicioni është më i vogël se numri i vendeve që i takojnë asaj partie ose koalicioni sipas këtij neni, vendet e paplotësuara ndahen midis partive dhe koalicioneve të tjera të partive që kanë paraqitur listë shumemërore, në përputhje me formulën e mëposhtme:

Numri i votave të vlefshme, të fituara nga secila nga partitë ose koalicionet e mësipërme pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre dhe rezultati shumëzohet me numrin e vendeve të paplotësuara. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve fillimisht i caktohet një numër vendesh shtesë, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Vendet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetje dhjetore më të mëdha. Në rast se mbetjet dhjetore për vendin e fundit janë të barabarta, ai caktohet me short.

PJESA E GJASHTË PARAQITJA E KANDIDATËVE

KREU I KANDIDATËT PËR TË CILËT VOTOHET DREJTPËRDREJT

Neni 76

Paraqitja e dokumentacionit të kandidatit

Dokumentacioni për paraqitjen e kandidatëve për deputet, kryetar bashkie ose komune, ose për këshillin e bashkisë ose të komunës, dorëzohet përkatësisht në KZZ ose, sipas rastit në KZQV, jo më vonë se 22 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Komisionet përkatëse marrin vendim për pranimin ose mospranimin e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 19 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Nëse komisionet vërejnë mospërputhje ose parregullsi në dokumentacionin e kandidimit përpara mbarimit të afatit të vërtetimit të tyre, sipas pikës 1 të këtij neni, komisioni i jep kandidatit mundësinë për t'i korrigjuar mospërputhjet, duke përcaktuar afatin për riparaqitjen e dokumentacionit, por jo më vonë se 19 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

KQZ-ja, jo më vonë se 3 ditë pas daljes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve, i lëshon kandidatit dokumentacionin e kandidimit, së bashku me formularët për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas nenit 78 të këtij Kodi.

Neni 77

Kërkesat për vlefshmërinë e dokumenteve të kandidimit

Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.

Dokumentet e kandidimit duhet të përmbajnë këto të dhëna:

emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen dhe adresën e kandidatit;

deklarimin e kandidatit që ai gëzon të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar për në organin për të cilin konkurron;

emrin dhe adresën e një personi të emëruar si përfaqësuesi zyrtar i tij, i cili duhet të gëzojë të drejtën e votës;

ç) një listë të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse, që mbështesin kandidaturën e tij, sipas nenit 78 të këtij Kodi;

një deklaratë nga partia që mbështet kandidatin, të nënshkruar nga kryetari i partisë, sipas përcaktimit të nenit 12 të këtij Kodi, përveç rastit të kandidatëve të pavarur.

Neni 78

Lista e zgjedhësve që mbështetin kandidatin

Për kandidatët për deputetë, dokumentet e kandidimit shoqërohen me një listë me nënshkrimet dhe numrat e identifikimit të 300 zgjedhësve që banojnë në atë zonë, emrat e të cilëve janë në listat paraprake të zgjedhësve të asaj zone zgjedhore.

Kandidatët për postin e kryetarit të bashkisë ose komunës dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

për njësitë zgjedhore me deri në 5.000 zgjedhës në listat e zgjedhësve, një listë me nënshkrimet dhe numrat e identifikimit të 50 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve;

për njësitë zgjedhore me 5.000 deri në 30.000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet dhe numrat e identifikimit të 100 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve;

për njësitë zgjedhore me më shumë se 30.000 zgjedhës, një listë me nënshkrimet dhe numrat e identifikimit të 300 zgjedhësve të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve.

Neni 79

Zëvendësimi i kandidatit

Kandidati mund ta tërheqë kandidaturën brenda 24 orëve nga verifikimi i bërë nga komisioni. Kandidati, që tërhiqet pas vërtetimit të bërë nga komisioni, nuk mund të zëvendësohet nga partia politike që ai përfaqëson.

Në rast se kandidati i regjistruar vdes përpara datës së zgjedhjeve, atëherë zgjedhjet në atë zonë shtyhen për katër javë. Në këtë rast KQZ-ja cakton një datë tjetër për paraqitjen e kandidaturës zëvendësuese.

Menjëherë pas mbarimit të afatit për tërheqjen e kandidaturës, komisioni përkatës i zgjedhjeve kryen këto veprime:

dërgon në KQZ një listë përfundimtare të kandidatëve të verifikuar; dhe publikon në gazeta, postera dhe mediat elektronike brenda juridiksionit të njësisë zgjedhore emrat dhe përkatësinë partiake të të gjithë kandidatëve, sipas renditjes së tyre në fletën e votimit, dhe sipas mënyrës dhe në kohën e caktuar nga KQZ-ja.

4. Në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin ose për kryetar bashkie ose komune, KZZ-ja, ose, sipas rastit, KZQV-ja publikon emrin dhe adresën e përfaqësuesit zyrtar të kandidatit.

Neni 80

Përfaqësuesi i kandidatit

Brenda 48 orëve nga verifikimi i dokumentacionit të kandidimit, çdo kandidat duhet të deklarojë emrin e përfaqësuesit të tij pranë KQZ-së. Përfaqësuesit e kandidatëve pranë KQV-së akreditohen nga KZZ-ja ose, sipas rastit, nga KZQV-ja. Caktimi i përfaqësuesve nuk është i detyrueshëm.

Gjatë zhvillimit të votimit, përfaqësuesit e kandidatëve e mbajnë dokumentin e identifikimit në një vend të dukshëm. Ata nuk mund të mbajnë veshje ose simbole ose të kryejnë veprime që kanë për qëllim ose mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve.

Përfaqësuesi i kandidatit mund të zëvendësohet nga kandidati ose përfaqësuesi zyrtar i tij, por jo gjatë 24 orëve të fundit përpara mbylljes së votimit dhe gjatë numërimit të votave në qendrën e votimit.

KREU II

LISTAT SHUMEMËRORE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT

Neni 81

Paraqitja e listave

Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore paraqesin në KQZ një listë kandidatësh për 40 vende në Kuvend, brenda afatit të parashikuar në nenin 76 të këtij Kodi.

Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë. Në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose humbjeje të së drejtës për të kandiduar të një kandidati të listës sipas këtij Kodi, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

Listat nënshkruhen nga kryetari i partisë ose, sipas rastit, nga kryetarët e partive të koalicionit. Listave u bashkëngjitet një deklaratë e nënshkruar nga çdo kandidat se gëzon të drejtën e votës dhe dëshiron të kandidojë.

Neni 82

Pranimi i listave

Kur partitë politike paraqesin një listë me më pak se 20 kandidatë, lista nuk pranohet nga KQZ-ja.

Neni 83

Verifikimi i listave nga KQZ-ja

KQZ-ja verifikon rregullsinë e listave shumemërore sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në nenin 76 të këtij Kodi për verifikimin e kandidatëve të drejtpërdrejtë.

Pas verifikimit të listave shumemërore, KQZ-ja i publikon ato në tri gazetatat me tirazh më të madh në shkallë vendi e në mediat elektronike dhe u dërgon një kopje të listës KZZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre, sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

Emrat e listave shumemërore të vërtetuara nuk mund të ndryshohen.

KREU III
LISTAT SHUMEMËRORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 84

Kushtet për vlefshmërinë e listave

Për caktimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive dhe të komunave, partitë politike të regjistruara paraqesin në KZQV një listë kandidatësh sipas këtyre kushteve:

Brenda afatit për paraqitjen e kandidaturave për kryetar bashkie dhe komune, i dorëzojnë KZQV-së një listë të kandidatëve sipas formularit të përgatitur nga KQZ-ja.

Çdo kandidat në listë deklaron se pranon të kandidojë për subjektin zgjedhor përkatës.

Lista nënshkruhet nga kryetari i partisë ose personi i autorizuar prej tij për të mbështetur kandidatët.

ç) Në rast vdekjeje të një kandidati të listës, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

Neni 85

Mospranimi i listave

KZQV-ja nuk e pranon listën e kandidatëve kur numri i kandidatëve në listë është më i vogël se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit.

Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë.

Neni 86

Verifikimi dhe publikimi i listave

KZQV-ja verifikon listat e paraqitura nga partitë. Pas verifikimit, KZQV-ja i publikon listat në shtypin dhe mediat vendore, i shpall ato në territorin e bashkisë ose të komunës dhe i dërgon menjëherë një kopje KQZ-së.

PJESA E SHTATË
PROCEDURAT E VOTIMIT

KREU I
FLETËT E VOTIMIT

Neni 87

Përgatitja dhe përmbajtja e fletëve të votimit

Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fleta e votimit nuk duhet të jetë transparente dhe duhet të përmbajë elemente sigurie të përcaktuara nga KQZ-ja.

Fletët e votimit prodhohen në blloqe me kundërfletë. Vetëm në kundërfletë shënohet numri i serisë.

Për zgjedhjet për Kuvend zgjedhësi voton me dy fletë të veçanta me ngjyra të ndryshme, një për kandidatët që konkurrojnë drejtpërdrejt në zonë dhe tjetra për partitë politike që konkurrojnë në ato zgjedhje. Fleta e votimit për subjektet zgjedhore është e njëjtë për të gjitha zonat e zgjedhjeve.

Për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, fleta e votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë ose të komunës është me ngjyrë të ndryshme nga fleta e votimit për kandidatët për kryetar bashkie ose komune.

Neni 88

Forma e fletëve të votimit

1. Fleta e votimit shtypet sipas modelit të përgatitur nga KQZ-ja. Pjesa e pasme e fletës së votimit ka një vend për të vendosur nënshkrimin e kryetarit e të zëvendëskryetarit dhe vulën e KQV-së.

2. Mosnënshkrimi i fletës së votimit nga një prej subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk përbën shkak për mosfillimin e procedurave të votimit.

Neni 89

Dërgimi i fletëve të votimit dhe materialeve të tjera

KQZ-ja u dërgon KZZ-ve ose, sipas rastit, KZQV-ve numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, vulat, procesverbalet e votimit, si dhe materiale të tjera, jo më vonë se tri ditë nga data e zgjedhjeve.

KZZ-ja ose, sipas rastit, KZQV-ja i dërgon KQV-ve numrin e nevojshëm të fletëve të votimit dhe materiale të tjera të votimit, jo më vonë se 12 orë përpara hapjes së votimit.

Fletët e votimit prodhohen në bazë të numrit të përgjithshëm të zgjedhësve, duke i shtuar 2 për qind.

KQZ-ja përcakton numrin shtesë të fletëve të votimit që dërgohen në qendrat e votimit.

Neni 90

Emrat e kandidatëve dhe të subjekteve në fletën e votimit

Emrat e kandidatëve për deputetë ose për kryetar të bashkisë ose komunës vendosen në fletën e votimit sipas rendit alfabetik të emrit të tyre.

Në fletën e votimit:

shkruhet emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit, ashtu sikurse figuron në dokumentacionin e kandidimit;

në të djathtë të emrit të kandidatit shkruhet emri dhe shkronjat nistore të partisë ose të koalicionit që përfaqëson kandidati, ose fjala “i pavarur”;

nuk shkruhet asnjë e dhënë tjetër për kandidatin.

3. Në fletën e votimit të subjekteve zgjedhore, emrat e partive politike të regjistruara vendosen sipas rendit alfabetik, së bashku me shkronjat nistore të partisë.

4. Zgjedhësi shënon në vendin e posaçëm në krah të emrit të kandidatit ose të partisë shenjën “x” ose “+”, ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë nga zgjedhësi.

KREU II

QENDRAT E VOTIMIT DHE ZONAT E TYRE

Neni 91

Krijimi i zonave të qendrave së votimit

Zona e qendrës së votimit nuk mund të ndahet në pjesë të shkëputura nga njëra-tjetra.

Për aq sa është e mundur, zona e qendrës së votimit duhet të ketë jo më shumë se 1.000 zgjedhës. Në rast se vërehet se zona e qendrës së votimit ka më shumë se 1.000 zgjedhës, KZZ-ja, ose sipas rastit, KZQV-ja mund të caktojë më shumë se një qendër votimi për atë zonë.

Kur një qendër banimi është larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 kilometra, aty ngrihet një qendër votimi e veçantë, në qoftë se ka së paku 50 zgjedhës.

Zona e qendrës së votimit caktohet nga KZZ-ja ose KZQV-ja, por KZZ-ja duhet të ruajë, për aq sa është e mundur, kufijtë e zonave të qendrave të votimit të caktuara nga KZQV-ja në zonën e saj.

Neni 92

Vendndodhja e qendrës së votimit

1. Në çdo zonë qendre votimi krijohet një ose më shumë qendra votimi.
2. Për aq sa është e mundur, qendra e votimit ngrihet në një ndërtesë publike me hyrje të lirë. Qendra e votimit nuk mund të ngrihet:

në një ndërtesë private pa autorizimin e KQZ-së;
në një ndërtesë që përdoret nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore dhe shëndetësore;
në ndërtesa që përdoren ose janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike ose kandidati, ose të afërmeve të tyre.

Neni 93

Qendrat e votimit në vende të posaçme

Kur në institucionet e posaçme gjenden të paktën 15 zgjedhës, që kanë të drejtë të votojnë për njësinë zgjedhore ku ndodhet institucioni, KZZ-ja ose sipas rastit KZQV-ja, krijon për këta zgjedhës një qendër votimi brenda institucionit.

Në institucionet shëndetësore me shumë pavione mund të ngrihet një qendër votimi e veçantë për çdo pavion, në qoftë se secili prej tyre ka më shumë se 15 zgjedhës.

Zgjedhësit me vendqendrim në repartet ushtarake dhe të rendit votojnë në qendrat më të afërta të votimit jashtë reparteve, të caktuara nga KZZ-ja.

Studentët e regjistruar në listat e zgjedhësve, sipas nenit 61 të këtij Kodi, votojnë vetëm në zonën e qendrës së votimit, në listën e së cilës janë shtuar.

KREU III

PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 94

Veprimet paraprake

Një orë përpara hapjes së votimit, KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit dhe në prani të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të vëzhguesve, kryen këto detyra:

I vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve.

Heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m.

Afishon udhëzimet e votimit në një vend të përshtatshëm brenda qendrës së votimit.

ç) Vendos materiale të tjera të kërkuara nga KQZ-ja.

Kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim; u tregon përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore kutinë e votimit të zbrazët dhe e vulos atë në mënyrën e caktuar nga KQZ-ja.

Anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që janë të pranishëm nënshkruajnë procesverbalin e hapjes së qendrës së votimit.

Neni 95

Hapja e votimit dhe prania e anëtarëve

Pas kryerjes së procedurave të parashikuara në nenin 94 të këtij Kodi, kryetari i KQV-së deklaron hapjen e votimit, por jo përpara orës së parashikuar në nenin 5 të këtij Kodi.

Sekretari i KQV-së shënon në procesverbalin e qendrës së votimit kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari që largohet prej qendrës së votimit.

KREU IV

PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Neni 96

Numri i kutive të votimit

Në zgjedhjet për Kuvendin, në qendrën e votimit vendosen dy kuti, njëra prej të cilave përdoret për votimin për kandidatët e zonës dhe tjetra për partitë politike ose koalicionet.

Në zgjedhjet vendore, një kuti përdoret për votimin për kandidatët për kryetar bashkie ose komune dhe një kuti tjetër për kandidatët për këshillin e bashkisë ose të komunës.

Në votimin në referendum përdoret një kuti votimi për çdo çështje për të cilën votohet.

Neni 97

Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit

Pas hyrjes në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së kartën e zgjedhësit.

Kryetari verifikon nëse numri i kartës së zgjedhësit është i njëjtë me numrin e shënuar anash emrit të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës të votimit.

Pasi verifikon që emri dhe numri i kartës së zgjedhësit janë të saktë, kryetari i heq vizë emrit të zgjedhësit; zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij; fleta e votimit nënshkruhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 88 të këtij Kodi, ndërsa sekretari vulos pjesën e prapme të fletës dhe ia jep atë zgjedhësit.

Në rast se zgjedhësi nuk pajiset me fletë votimi sipas pikës 3 të këtij neni, rasti shënohet në procesverbal, duke shkruar emrin e zgjedhësit, numrin e identifikimit të tij dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme.

Në rast se përfaqësuesi i një kandidati ose një anëtar i KQV-së vë në dyshim identitetin e një zgjedhësi që ka marrë fletë votimi, rasti mbahet shënim në procesverbal, duke shkruar emrin e kundërshtuesit, arsyet e kundërshtimit, emrin dhe numrin e identifikimit të zgjedhësit dhe arsyet pse kryetari i KQV-së e pajisi personin me fletë votimi.

Neni 98

Votimi

Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe voton duke shënuar fletën e votimit në vendin e caktuar.

Pasi voton në dhomën e fshehtë, zgjedhësi e palos fletën e votimit në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme dhe del nga dhoma e fshehtë.

Para se zgjedhësi ta hedhë fletën e votimit në kutinë e votimit, kryetari ose një anëtar i caktuar prej tij kontrollon nëse ajo ka vulën e KQV-së dhe nënshkrimin sipas nenit 88 të këtij Kodi.

Pas kësaj, zgjedhësi hedh fletën e votimit në kutinë e votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

Me përjashtim të nenit 100 të këtij Kodi, zgjedhësi voton vetëm për vete.

Neni 99

Fletët e votimit të dëmtuara

Nëse shënim i fletës e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, fleta e votimit nuk futet në kuti, por në zarfin e votave të dëmtuara. Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër dhe rasti mbahet shënim në procesverbal. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin e votave të dëmtuara dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

Nëse zgjedhësi bën një shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Rasti mbahet shënim në procesverbal. Zgjedhësit, që dëmton fletën e dytë të votimit, nuk i jepet fletë votimi tjetër.

Fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në asnjë rast në kutinë e votimit.

Neni 100

Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

Zgjedhësi që, për arsye fizike, nuk mund të votojë vetë, mund të kërkojë ndihmën e një zgjedhësi tjetër që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

Para se të shënojë fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në procesverbal se do të votojë sipas udhëzimeve dhe se nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve të çdo niveli nuk mund të ndihmojnë zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë.

Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

Neni 101

Ruajtja e rendit në qendrën e votimit

Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kërkon ndihmën e policisë.

Kryetari ose zëvendëskryetari i KQV-së njofton menjëherë KZZ-në ose KZQV-në për incidentin e ndodhur.

Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja u kërkon forcave të policisë të largohen nga qendra e votimit dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit.

Neni 102

Personat e pranishëm në qendrën e votimit

Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm personat e mëposhtëm:

- a) Anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e akredituar të subjekteve zgjedhore.
- b) Zgjedhësit që presin të votojnë.
- c) Vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.

2. Në qoftë se ka zgjedhës që presin të votojnë, kryetari i KQV-së mund të vendosë që ata të presin jashtë qendrës së votimit, për të lehtësuar votimin e personave brenda qendrës.

3. Personat që shërbejnë si vëzhgues për një kandidat (jo përfaqësuesit e akredituar të qendrës së votimit) mund të hyjnë në qendrën e votimit për t'u takuar me përfaqësuesin e akredituar të kandidatit, por takimi bëhet jashtë qendrës së votimit.

Asnjë person i armatosur, duke përfshirë edhe forcat e policisë dhe ushtarakët, nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit, përveçse në rrethanat e nenit 101 të këtij Kodi.

Neni 103

Votimi në institucione të posaçme

Votimi në spitale, burgje, vende paraburgimi dhe konvikte kryhet sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod për qendrat e votimit dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

Neni 104

Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit

Në zgjedhjet për Kuvendin dhe referendumet e përgjithshme, zgjedhësit që shërbejnë në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit votojnë në njësinë zgjedhore ku ndodhen repartet e tyre.

Në zgjedhjet dhe referendumet vendore, zgjedhësit që shërbejnë në Forcat e Armatosura ose në Forcat e Rendit votojnë në zonën e qendrës së votimit të vendbanimit të tyre.

KREU VII
MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 105
Mbyllja e votimit

Qendrat e votimit mbylleen në orën e caktuar në nenin 5 dhe në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të këtij Kodi.

Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm personat e mëposhtëm: Anëtarët e KQV-së, një përfaqësues i akredituar për çdo kandidat, një përfaqësues i akredituar për çdo parti politike të regjistruar që ka paraqitur listë shumemërore por që nuk ka emëruar kandidat për deputet ose për kryetar bashkie ose komune, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.

Neni 106
Numërimi i votave

1. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit, kryetari, së bashku me anëtarët e KQV-së, kryen veprimet e mëposhtme, sipas kësaj radhe:

Përcakton numrin e personave që kanë votuar sipas listës së zgjedhësve dhe e regjistron atë në procesverbalin e qendrës së votimit.

Përcakton numrin e fletëve të votimit të përdorura në bazë të numrit të serisë së kundërfletëve.

Numëron fletët e dëmtuara që gjenden në zarfin e fletëve të dëmtuara, e zbret këtë numër nga numri i fletëve të përdorura dhe verifikon nëse numri i fletëve të përdorura i korrespondon numrit të votuesve që kanë votuar sipas listës.

ç) Verifikon nëse vula mbi kutinë e votimit është e njëjtë me vulën e vendosur para hapjes së votimit.

d) Hap kutitë e votimit, sipas radhës së përcaktuar nga KQV-ja dhe nxjerr të gjitha fletët e votimit.

dh) Numëron fletët e votimit që gjenden në kutinë e votimit, pa i shqyrtuar ato, verifikon nëse numri i fletëve është i njëjtë me numrin e parashikuar në shkronjën “c” të këtij neni dhe i regjistron të dhënat në procesverbal.

e) Ndan fletët e votimit sipas kandidatëve, duke vendosur mënjatë ato fletë ku nuk është e qartë se për kë ka votuar zgjedhësi dhe, duke verifikuar nëse ato përmbajnë nënshkrimin e parashikuar në nenin 88 të këtij Kodi dhe vulën e KQV-së, si dhe nëse ato janë të vlefshme nga të gjitha anët e tjera.

ë) Numëron fletët e votimit sipas kandidatëve, regjistron numrin e tyre në procesverbal dhe i fut fletët për çdo kandidat në zarfe të veçanta.

f) I vendos të gjitha fletët e shpallura të pavlefshme, sipas pikës 3 të këtij neni, në një zarf të posaçëm dhe regjistron numrin e tyre në procesverbal.

Kur kryetari i KQV-së vendos se për cilin kandidat llogaritet fleta e votimit ose shpall të pavlefshme një fletë votimi dhe vendimi i tij kundërshtohet nga një anëtar i KQV-së ose nga përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor, KQV-ja voton dhe merr vendim për këtë çështje. Kryetari shkruan një numër në anën e pasme të fletës dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shtojë vërejtjet e tij në procesverbal.

Fleta e votimit shpallet e pavlefshme kur është votuar për më shumë se një kandidat ose parti politike; kur nuk është e qartë se për kë është votuar; kur fleta përmban shënime që mund të zbulojnë identitetin e zgjedhësit; kur zgjedhësi ka bërë shënime të tjera ose ka votuar për një person ose parti që nuk është në fletën e votimit dhe kur fleta nuk përmban vulën e KQV-së ose nënshkrimin e parashikuar në nenin 88 të këtij Kodi.

Nëse fletët e votimit që gjenden në kutinë e votimit nuk kanë të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletët e caktuara nga KQZ-ja, ato vendosen në një zarf të veçantë dhe nuk merren parasysh në numërimin e fletëve të votimit.

Pas numërimit të fletëve të votimit, kryetari i KQV-së plotëson tabelën e rezultateve të qendrës së votimit dhe e nënshkruan atë së bashku me të gjithë anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që janë të pranishëm. Të gjithë personat e pranishëm, duke përfshirë vëzhguesit shqiptarë dhe të huaj, pajisen me nga një kopje të tabelës. Nëse një anëtar i KQV-së ose një përfaqësues i pranishëm kundërshton përmbajtjen e tabelës, KQV-ja voton dhe merr vendim për çështjen. Kryetari regjistron çështjen në procesverbal, natyrën e saj dhe arsyetimin e vendimit. Përmbajtja e vendimit pasqyrohet në tabelën përfundimtare. Nëse një anëtar ose përfaqësues e kundërshton vendimin e KQV-së, ai mund të bëjë vërejtje në procesverbal.

Pas numërimit të fletëve të votimit për kryetar bashkie ose komune ose për deputet të zonës njëemërore, zarfet me fletët e votimit futen në kutinë e votimit, e cila vendoset menjëherë. Pas kësaj, përsëriten procedurat e mësipërme për numërimin e fletëve të votimit për listat shumëemërore.

Pas numërimit të fletëve të votimit për listat shumëemërore, kryetari i KQV-së plotëson tabelën e përgjithshme të rezultateve të qendrës së votimit, e cila përmbledh të dhënat e të gjitha tabelave.

Kopjet origjinale të tabelave, procesverbalet dhe vula e KQV-së vendosen në kutinë e votimit që përmban fletët e votimit për kryetar bashkie ose komune, ose deputet të zonës njëemërore. Një kopje e tabelës vendoset në një zarf të posaçëm, i cili nuk vendoset në kutinë e votimit.

Çdo kuti votimi vulolet dhe numri identifikues i vulës regjistrohet në procesverbal.

Kryetari dhe sekretari i KQV-së i dorëzojnë KZQV-së ose KZZ-së, në mënyrën e parashikuar nga KZQV-ja ose KZZ-ja, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, kutitë e votimit dhe zarfin me procesverbalet e votimit. KZQV-ja ose KZZ-ja i lëshon kryetarit të KQV-së një aktдорëzimi.

Neni 107

Shpallja e rezultateve

1. Jo më vonë se dy ditë pas ditës së zgjedhjeve, KZQV-ja ose KZZ-ja, në prani të anëtarëve të komisionit, të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të vëzhguesve të akredituar shqiptarë dhe të huaj, kryen detyrat e mëposhtme dhe shpall rezultatet e zgjedhjeve:

a) Kryetari i komisionit verifikon numrin e kutive të votimit.

b) Kutitë e votimit hapen një nga një, duke verifikuar nëse vula është e njëjtë me vulën e regjistruar në procesverbal dhe nëse kutitë përmbajnë procesverbalet, zarfet me fletët e votimit, fletët e votimit të papërdorura, kundërfletët dhe vulën e KQV-së. Kopja origjinale e tabelës nxirret nga kutia.

c) Çdo anëtar i komisionit mund të shqyrtojë procesverbalet.

ç) Fletët e votimit nuk mund të shqyrtohen, të hiqen nga kutia ose të numërohen në asnjë rast.

d) Kutia e votimit mbyllet dhe vulolet përsëri, duke lënë jashtë tabelën origjinale të rezultateve. Numri i vulës regjistrohet në procesverbalin e komisionit.

dh) Çdo parregullsi, që konstatohet në kutinë e votimit, mbahet shënim në procesverbal.

e) Pasi nxirren të gjitha tabelat origjinale të rezultateve, kryetari i komisionit harton tabelën e rezultateve për njësinë zgjedhore dhe deklaron personin e zgjedhur deputet ose kryetar bashkie ose komune, anëtarët e këshillit të bashkisë ose komunës, numrin e votave për listat shumëemërore dhe, sipas rastit, kandidatët që marrin pjesë në raundin e dytë të zgjedhjeve.

ë) Kryetari i komisionit, së bashku me anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që janë të pranishëm, firmosin tabelën e rezultateve për njësinë zgjedhore. Kryetari u jep nga një kopje të tabelës të gjithë anëtarëve të komisionit, përfaqësuesve të pranishëm, kandidatëve dhe vëzhguesve shqiptarë dhe të huaj që janë të pranishëm. Kopja origjinale e tabelës i dërgohet KQZ-së, ndërsa një kopje e saj afishohet në një vend të dukshëm brenda qendrës së votimit.

f) Në rast se një anëtar i komisionit ose përfaqësues i pranishëm e kundërshton tabelën, komisioni voton dhe merr vendim. Kryetari shënon në procesverbal natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Tabela përfundimtare pasqyron vendimin e marrë. Në rast se një anëtar ose përfaqësues e kundërshton vendimin e komisionit, ai mund të bëjë vërejtje në procesverbal.

Të gjitha kutitë e votimit dhe procesverbalet ruhen nga KZQV-ja ose KZZ-ja në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe mund të hapen vetëm nga gjykata gjatë rinumërimit të fletëve të votimit ose me urdhër të Gjykatës Kushtetuese, ose sipas rastit, të Gjykatës së Lartë, në përputhje me nenin 141 të këtij Kodi.

Rinumërimi i fletëve të votimit mund të bëhet vetëm pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

Gjatë procedurave të parashikuara në këtë nen mund të jenë të pranishëm vetëm personat e

përmendur në pikën 1 të këtij neni.

KREU VIII RINUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 108

Kriteret e rinumërimit të fletëve të votimit

Nëse, pasi KZQV-ja ose KZZ-ja ka shpallur zgjedhjen e një personi (me përjashtim të kandidatëve të listave shumemërore), rezulton se diferenca mes votave të fituesit dhe kandidatit që ka dalë i dyti është më e vogël se numri i përgjithshëm i votave të shpallura të pavlefshme gjatë numërimit ose nëse diferenca e mësipërme është jo më shumë se 25 vota, fletët e votimit rinumërohen në mënyrën e përcaktuar në këtë kre.

Nëse, pasi KZQV-ja ose KZZ-ja ka shpallur zgjedhjen e një personi (me përjashtim të kandidatëve të listave shumemërore), rezulton se diferenca e mësipërme është jo më shumë se 150 vota dhe jo më e madhe se numri i përgjithshëm i votave të shpallura të pavlefshme gjatë numërimit, KZQV-ja ose KZZ-ja, me kërkesën e kandidatit që ka dalë i dyti, organizon rinumërimin e votave si vijon:

Kërkesa bëhet në formën e caktuar nga KQZ-ja dhe nënshkruhet nga kandidati dhe përfaqësuesi i tij zyrtar.

Kërkesa për rinumërim i dorëzohet kryetarit të komisionit përkatës jo më vonë se ora 1600 e ditës së dytë pas numërimit përfundimtar të votave nga KZQV-ja ose KZZ-ja.

Me marrjen e kërkesës për rinumërim, KZQV-ja ose KZZ-ja organizon rinumërimin e votave, i cili duhet të fillojë jo më vonë se 48 orë pas marrjes së kërkesës.

Në rastet kur kërkohet rinumërimi i votave sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kryetari i komisionit njofton menjëherë kryetarin e gjykatës së rrethit, i cili organizon zgjedhjen me short të tre gjyqtarëve të kësaj gjykate për të bërë rinumërimin e votave brenda afatit të caktuar në këtë Kod.

Shpenzimet që lidhen me rinumërimin e votave mbulohen nga KQZ-ja.

Neni 109

Rinumërimi i votave

Rinumërimi i votave kryhet në një sallë publike me përmasa të mjaftueshme për kutitë e votimit të të gjitha qendrave të votimit të asaj njësie zgjedhore, për anëtarët e KZQV-së ose KZZ-së, si dhe për përfaqësuesit e akredituar të kandidatëve ose partive që dëshirojnë të jenë të pranishëm.

Në rinumërimin e votave mund të marrë pjesë vetëm një përfaqësues për çdo subjekt zgjedhor.

Anëtarët e KZQV-së ose KZZ-së marrin pjesë në rinumërimin e votave si vëzhgues. Në rinumërimin e votave mund të marrin pjesë si vëzhgues edhe një ose më shumë anëtarë të KQZ-së.

Sekretari i komisionit përkatës sjell të gjitha kutitë e votimit dhe procesverbalet e votimit në vendin ku bëhet rinumërimi dhe ndihmon gjyqtarët në kryerjen e rinumërimit. Me pëlqimin e gjykatës, sekretari mund të mbajë edhe një ose më shumë ndihmës të tjerë të paanshëm.

Gjatë rinumërimit, gjykata përgjigjet për ruajtjen e kutive të votimit dhe të procesverbaleve.

Në kohën e caktuar për fillimin e rinumërimit, gjykata dhe sekretari i komisionit verifikojnë nëse KZQV-ja ose KZZ-ja ka dorëzuar të gjitha materialet e nevojshme. Gjkata mban shënim materialet që nuk janë dorëzuar.

Rinumërimi i votave fillon në orën 800 dhe vazhdon deri në përfundimin e tij.

Në fund të rinumërimit, gjykata plotëson tabelën e rinumërimit të votave, në formën e caktuar nga KQZ-ja dhe u lëshon nga një kopje anëtarëve të komisionit përkatës, anëtarëve të KQZ-së dhe çdo kandidati ose përfaqësuesi të pranishëm.

Pasi merr tabelën e rinumërimit, KZQV-ja ose KZZ-ja shpall menjëherë rezultatin e zgjedhjeve.

Neni 110

Procedurat për rinumërimin

Në vendin dhe kohën e caktuar për rinumërimin, gjykata:
verifikon nëse kutitë e votimit dhe procesverbalet janë vendosur në një vend të dukshëm;
fillon rinumërimin nga qendra e votimit numër 1 dhe vazhdon me radhë rinumërimin e të gjitha fletëve të votimit të të gjitha qendrave të votimit;
i shqyrton kutitë e votimit një nga një.

Përpara se të hapë kutinë e votimit, gjykata verifikon nëse vula e kutisë së votimit është e njëjtë me vulën e shënuar në procesverbalet e KZQV-së ose KZZ-së. Nëse vula nuk është e njëjtë, kutia nuk duhet të hapet.

Pasi verifikohet se vula e kutisë është e njëjtë, rinumërimi procedon në mënyrë plotësisht të dukshme për të pranishmit dhe sipas radhës së mëposhtme:

Sekretari hap kutinë dhe nxjerr procesverbalet, tabelat dhe vulën e KQV-së dhe verifikon nëse ato janë materialet e rregullta të asaj qendre votimi.

Sekretari nxjerr zarfat me fletët e votimit të numëruara në qendrën e votimit, zarfat me fletët e votimit të pavlefshme dhe zarfat me fletët e votimit të dëmtuara gjatë votimit, si dhe fletët e votimit të papërdorura dhe kundërfletët.

Gjykata verifikon të dhënat e tabelave në lidhje me numrin e fletëve të votimit të papërdorura, numrin e kundërfletës së fundit dhe numrin e fletëve të votimit të dëmtuara. Gjykata i vendos këto materiale në zarfin e caktuar për këtë qëllim dhe i shënon të dhënat në procesverbalin e rinumërimit.

ç) Gjykata hap zarfet me fletët e votimit, pa i kontrolluar ato dhe i grupon sipas zarfit nga i cili nxirren. Fletët e votimit të gjetura në zarfe numërohen dhe rezultati krahasohet me numrin e shënuar në tabelën e qendrës së votimit. Në rast mospërputhjeje, konsiderohet i saktë numri i fletëve të votimit të gjetura në zarf gjatë rinumërimit.

Pasi verifikon numrin e votave, sipas tabelës së qendrës së votimit, gjykata vazhdon me shqyrtimin e të gjitha fletëve të votimit, duke kontrolluar nëse fleta e votimit është vulosur dhe nënshkruar sipas nenit 88 të këtij Kodi dhe deklaron se për kë është votuar. Gjatë rinumërimit gjykata ushtron kompetencat e KQV-së dhe mund të ndryshojë vendimin e KQV-së të shënuar në procesverbal.

dh) Gjatë shqyrtimit të një flete votimi që është kundërshtuar nga një ose më shumë anëtarë ose përfaqësues të KQV-së ose që është shpallur e pavlefshme nga KQV-ja gjatë numërimit, gjykata shqyrton të gjitha kundërshtimet dhe vërejtjet që gjenden në procesverbalin e votimit, në lidhje me atë fletë votimi. Pasi merr vendim në lidhje me atë fletë votimi, gjykata sqaron arsyet përkatëse, të cilat mbahen shënim në procesverbalin e rinumërimit.

Pas shqyrtimit të të gjitha fletëve të votimit të gjendura në kutitë e votimit, gjykata shpall rezultatet e qendrës së votimit dhe harton procesverbalin e rinumërimit të votave për qendrën e votimit; e nënshkruan atë së bashku me sekretarin; rivendos të gjitha materialet në kutinë e votimit, së bashku me një kopje të deklaratës së rinumërimit të votave; e vulos kutinë e votimit dhe fillon të njëjtën procedurë për qendrën tjetër të votimit.

ë) Para se ta vulosë kutinë e votimit, sipas shkronjës “e” të këtij neni, gjykata i lejon përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, kandidatët dhe anëtarët e komisionit të zgjedhjeve të shqyrtojnë procesverbalet e votimit dhe të mbajnë shënime. Fletët e votimit mund të shqyrtohen vetëm nga gjykata.

Pas rinumërimit të votave për të gjithë njësinë zgjedhore dhe pas hartimit të procesverbalit të rinumërimit për çdo qendër votimi, gjykata harton tabelën e rinumërimit të votave, një kopje e së cilës u jepet të gjithë personave të pranishëm.

4. Në përfundim të procedurës së rinumërimit, gjykata ia dorëzon kutitë e votimit dhe procesverbalet e votimit komisionit të zgjedhjeve, i cili i ruan ato në mënyrën e përcaktuar në nenin 149 të këtij Kodi.

5. KQZ-ja harton formularët që përdoren nga gjykata në këtë kre.

Neni 111

Listat shumëmbrojtore

Fletët e votimit për këshillin e bashkisë ose të komunës rinumërohen kur shumica e fletëve të votimit të shpallura të pavlefshme dhe atyre të kundërshtuara mund të ndikojë në ndarjen e mandateve në këshill. Rinumërimi i fletëve të votimit për këshillat vendore bëhet sipas procedurave të

rinumërimin të parashikuara në këtë kre.

Fletët e votimit për listat shumëmbrore të kandidatëve për deputet nuk rinumërohen.

Neni 112

Vendimet dhe ankimet

Të gjitha vendimet gjatë rinumërimin të votave merren nga gjykata.

Vendimet e marra gjatë rinumërimin të votave janë të formës së prerë.

PJESA E NËNTË

PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

Neni 113

Pavlefshmëria e zgjedhjeve

KQZ-ja i shpall të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit, në njësitë zgjedhore ose në të gjithë territorin e Republikës, në qoftë se vëren:

shkelje të ligjit ose fatkeqësi natyrore me përmasa të tilla që mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandateve në Kuvend ose në këshillat vendore, në rezultatin e zgjedhjeve për kryetar bashkie ose komune, ose në rezultatin e referendumeve; ose

se votimi nuk ka filluar ose është ndërprerë për më shumë se gjashtë orë rresht.

Pika 1 e këtij neni zbatohet për ato njësi territoriale ku janë vërejtur parregullsitë e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 ose ku është ndërprerë votimi sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

KQZ-ja vendos për pavlefshmërinë e zgjedhjeve pas konsultimeve me KZQV-në ose me KZZ-në përkatëse.

Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme, sipas këtij neni, përsëriten pas jo më shumë se 4 javëve.

Çdo person i interesuar mund ta ankimojë vendimin e KQZ-së për t’i shpallur zgjedhjet të pavlefshme ose jo në Gjykatën Kushtetuese ose, sipas rastit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit të KQZ-së.

PJESA E TETË

REFERENDUMET

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 114

Kuptimi i referendumit

Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës.

Votimi për referendum kryhet sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

Në referendum konsiderohet fituese alternativa që ka fituar shumicën e votave të vlefshme, por jo më pak se një të tretën e numrit të zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kre.

Neni 115

Kufizime në ushtrimin e të drejtës së referendumit

Asnjë referendum kushtetues ose i përgjithshëm nuk mund të zhvillohet datën e zgjedhjeve për Kuvend ose për organet e qeverisjes vendore.

Nuk mund të zhvillohet referendum kushtetues ose i përgjithshëm gjatë periudhës nga gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të Kuvendit të ri.

Nuk mund të zhvillohet referendum vendor gjatë periudhës nga tre muaj para përfundimit të

mandatit të organeve të qeverisjes vendore, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të këshillave vendore.

Kur shpallen zgjedhje të parakohshme për Kuvendin, procedura për zhvillimin e referendumit pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga mbledhja e parë e Kuvendit të ri.

Kur në një njësi të qeverisjes vendore shpallen zgjedhje të parakohshme, procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore.

Në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës, kërkesat për referendum, që nuk kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat e këtij kreu, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri në vitin pasardhës.

Neni 116

Procedurat për zhvillimin e referendumeve

Referendumet kushtetuese dhe referendumet e përgjithshme administrohen nga KQZ-ja nëpërmjet KZZ-ve dhe, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, për aq sa është e mundur ose e nevojshme.

Referendumet vendore administrohen nga KQZ-ja nëpërmjet KZQV-ve dhe, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod për zhvillimin e zgjedhjeve vendore, për aq sa është e mundur ose e nevojshme.

Për referendumet në nivel qarku, KQZ-ja krijon komisionin zgjedhor në nivel qarku. Përbërja e këtij komisioni propozohet nga Këshilli i Qarkut sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod për përbërjen e KZQV-së.

Kur në të njëjtën datë zhvillohet më shumë se një referendum, fletët e votimit të secilit referendum janë me ngjyra të ndryshme.

Neni 117

Miratimi i projektligjeve që votohen në referendum

Projektligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shfuqizimi i një ligji me referendum hyn në fuqi menjëherë me shpalljen e rezultatit. Kuvendi, me kërkesë të arsyetuar të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë shtyrjen e shfuqizimit të ligjit ose të pjesës së shfuqizuar të tij, por jo për më shumë se 60 ditë.

KREU II

LLOJE TË VEÇANTA REFERENDUMESH

SEKSIONI 1

REFERENDUMI KUSHTETUES

Neni 118

Llojet e referendumit kushtetues

Referendumi kushtetues, sipas pikës 4 të nenit 177 të Kushtetutës, zhvillohet me vendim të dy të tretave të të gjithë deputetëve që projektamendamenti kushtetues të votohet drejtpërdrejt nga populli. Referendumi kushtetues, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, është referendum që kërkohet nga një e pesta e deputetëve, për t'ia nënshtruar votimit popullor amendamentin kushtetues, të miratuar nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 119

Procedurat fillestare

Kërkesa për referendum kushtetues për rishikimin e Kushtetutës përmban tekstin e projektligjit për rishikimin e Kushtetutës.

Kërkesat për referendum, në përputhje me pikën 5 të nenit 177 të Kushtetutës, i dorëzohen

Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit brenda 15 ditëve nga miratimi i amendamentit kushtetues nga Kuvendi.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ia dërgon menjëherë Gjykatës Kushtetuese dhe Presidentit të Republikës vendimin e Kuvendit (ose, sipas rastit, kërkesën e një të pestës së deputetëve), që kërkojnë zhvillimin e një referendumi kushtetues.

Neni 120

Shqyrtimi paraprak nga Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, shqyrton paraprakisht kushtetueshmërinë e mbajtjes së referendumit kushtetues, sipas pikës 4 ose 5 të nenit 177 të Kushtetutës.

Neni 121

Procedurat e mëtejshme për referendumin kushtetues

Kur Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa për referendum kushtetues është në pajtim me Kushtetutën ose nuk shprehet brenda afatit, Presidenti i Republikës cakton datën e zhvillimit të referendumit në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës.

Në këtë rast, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit njofton KQZ-në për zhvillimin e referendumit kushtetues dhe i dërgon tekstin e projektligjit që do të votohet në referendum. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit e boton tekstin e projektligjit që do të votohet në referendum në tri gazetat me tirazhin më të madh në shkallë vendi.

Në rast se Gjykata Kushtetuese vendos që kërkesa për referendum kushtetues nuk është në pajtim me Kushtetutën, procedura për zhvillimin e referendumit pushon. Në rastin e kërkesës sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, amendamentet kushtetuese të miratuara nga Kuvendi, shpallen nga Presidenti i Republikës dhe hyjnë në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Amendamentet kushtetuese, që i nënshtrohen referendumit sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, rrëzohen kur më shumë se gjysma e të gjithë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit kanë votuar kundër tyre. Në qoftë se amendamentet kushtetuese nuk rrëzohen në referendum, ato shpallen nga Presidenti i Republikës dhe hyjnë në fuqi të paktën 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKSIONI 2

REFERENDUMI I PËRGJITHSHËM

Neni 122

Nisma për referendum të përgjithshëm

Pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit kanë të drejtën e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojnë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e këtij Kodi.

Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit.

Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme.

Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për shfuqizimin e një ligji ose të një pjese të tij, përmban:

titullin, numrin dhe datën e miratimit të ligjit që kërkohet të shfuqizohet si dhe, në qoftë se kërkohet të shfuqizohet vetëm një pjesë e ligjit, dispozitat përkatëse;

arsyet përse ligji ose dispozita të veçanta të tij duhen shfuqizuar.

5.Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj, si dhe qëndrimin e nismëtarëve në

lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoke dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “Po” ose “Jo”.

Neni 123

Fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve

KQZ-ja, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës-tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkojnë të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

Nënshkrimet dhe numrat e kartës së zgjedhësit, në mbështetje të kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.

Neni 124

Verifikimi i kërkesës nga KQZ-ja

KQZ-ja verifikon nënshkrimet dhe numrat e kartës së zgjedhësve, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra prej saj.

KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi u njoftohet menjëherë nismëtarëve. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mospranimit.

Brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit, grupi nismëtar mund t'i deklarojë KQZ-së se është i gatshëm të korrigjojë parregullsitë e vërejtura. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat deri në 30 ditë për riparaqitjen e kërkesës. KQZ-ja vendos brenda 10 ditëve për pranimin ose jo të kërkesës së riparaqitur dhe i njofton menjëherë nismëtarët.

Neni 125

Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese

Pas verifikimit të rregullsisë së kërkesave, KQZ-ja ia përcjell kërkesat për referendum të përgjithshëm Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 115 të këtij Kodi. KQZ-ja njofton njëkohësisht Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin për kërkesat e pranuar.

Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetushmërinë e kërkesave për referendum të përgjithshëm dhe nëse ato janë formuluar në përputhje me pikat 3 dhe 5 të nenit 122, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së kërkesave nga KQZ-ja.

Presidenti i Republikës vendos për zhvillimin ose jo të referendumeve për çështje të rëndësishme të veçantë pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit brenda të cilit ajo duhet të shprehet. Në qoftë se vendos që referendumi i kërkuar nuk duhet të zhvillohet, Presidenti njofton me shkrim KQZ-në për arsyet, të cilat KQZ-ja ua dërgon nismëtarëve.

Neni 126

Caktimi i datës së referendumit të përgjithshëm

Presidenti i Republikës cakton datën e votimit për referendum të përgjithshëm, në përputhje me pikën 3 të nenit 152 të Kushtetutës.

Neni 127

Referendume me nismën e Kuvendit

Kur Kuvendi vendos për zhvillimin e referendumeve të përgjithshme, në përputhje me pikën 2 të nenit 150 të Kushtetutës, zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, rregullat e parashikuara në këtë seksion për referendumet, sipas pikës 1 të nenit 150 të Kushtetutës.

SEKSIONI 3 REFERENDUMET VENDORE

Neni 128

Nisma për referendum vendor

Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës ose bashkisë dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit, ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në bashkinë ose komunën përkatëse.

Një numër këshillash bashkiakë ose komunalë, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

Për zhvillimin e referendumit vendor zbatohen, për aq sa është e mundur ose e nevojshme, dispozitat e parashikuara për referendumin e përgjithshëm në pikat 2 dhe 5 të nenit 122, në nenin 123 dhe në pikën 2 të nenit 124 të këtij Kodi.

PJESA E NËNTË FUSHATA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Neni 129

Periudha e fushatës zgjedhore

Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë përpara fillimit të votimit.

Kur zhvillohet një raund i dytë ose zgjedhjet përsëriten në përputhje me këtë Kod, fushata vazhdon pas përfundimit të raundit të parë dhe përfundon 24 orë para fillimit të votimit.

Neni 130

Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës

Gjatë fushatës zgjedhore, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve.

Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositësin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.

Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet e depolitizuara.

Ndalohet propaganda në favor ose kundër një kandidati ose subjekti tjetër zgjedhor nga ana e të huajve.

Neni 131

Materialet propagandistike

Organet e qeverisjes vendore caktojnë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike.

Neni 132

Fushata zgjedhore në Radiotelevizionin Publik

Gjatë fushatës zgjedhore, Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas, në dispozicion të partive

politike të regjistruara dhe të KQZ-së, që ndahet sipas rregullave të mëposhtme:

KQZ-së i vihen në dispozicion gjithsej dy orë, sipas segmenteve orare të kërkuara prej saj. Të paktën dy të tretat e këtij minutazhi duhet të jenë brenda segmentit orar 1800-2200.

KQZ-ja cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 15 minutash në Televizionin Publik dhe 15 minuta në Radion Publike për çdo parti parlamentare që merr pjesë në raundin e parë të zgjedhjeve.

Çdo parti jashtëparlamentare që merr pjesë në raundin e parë të zgjedhjeve përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike.

ç) Në çdo program ose reklamë radiotelevizive në shërbim të propagandës zgjedhore duhet të përcaktohet qartë subjekti zgjedhor përkatës.

Minutazhi i përgjithshëm që vihet në dispozicion të partive politike gjatë një fushate zgjedhore është jo më shumë se 10 orë.

2. Për raundin e dytë të zgjedhjeve, partitë politike, kandidatët e të cilëve marrin pjesë në raundin e dytë, përfitojnë 15 minuta në Televizionin Publik dhe 15 minuta në Radion Publike. Kandidatët e pavarur që marrin pjesë në raundin e dytë përfitojnë 3 minuta në Televizionin Publik dhe 3 minuta në Radion Publike.

3. Radiotelevizioni Publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit të parashikuara në nenet 4, 36 dhe 41 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion e televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”. Minutazhi falas që përfitojnë partitë politike sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të caktohet si pjesë e lajmeve dhe programeve informative.

4. Radiotelevizioni Publik nuk mund të përgatisë ose transmetojë reklama politike me pagesë.

5. Gjatë fushatave për referendum të përgjithshëm, Radiotelevizioni Publik vë minutazh të barabartë prej jo më shumë se tri orësh gjithsej në dispozicion të partive politike që mbështesin secilën prej alternativave.

Neni 133

Minutazh falas për KQZ

Përveç minutazhit sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 132 të këtij Kodi, Radioja dhe Televizioni Publik venë 60 minuta falas në vit, duke filluar nga 1 janari 2001, në dispozicion të KQZ-së për informimin e zgjedhësve. Ky minutazh caktohet në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 132.

Neni 134

Orari i transmetimeve

Jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjes, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik, në bazë të të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja përpartitë e regjistruara, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie dhe organizon, nën mbikëqyrjen e KQZ-së, shortin për caktimin e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar.

Minutazhi në dispozicion të partive politike dhe të kandidatëve të pavarur caktohet në segmentin orar 1800- 2200 të çdo dite të fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit.

Neni 135

Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private

Radiot dhe televizionet private e pasqyrojnë fushatën zgjedhore në përputhje me parimet e parashikuara në nenet 4, 36 dhe 41 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë fushatave zgjedhore, radiot dhe televizionet private mund të transmetojnë reklama zgjedhore të partive politike, të cilat ofrohen për të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhje me tarifën më të ulët që zbatohet për segmentin orar të kërkuar. Këto tarifa janë të barabarta me tarifat që janë në fuqi dhe të njohura publikisht në ditën e shpalljes së datës së zgjedhjeve.

Gjatë fushatave zgjedhore, për çdo lloj zgjedhjeje, radiot dhe televizionet private nuk mund të transmetojnë më shumë se pesë minuta reklamë në ditë për çdo parti politike ose kandidat të pavarur.

Ndalohe transmetimi i reklamave komerciale gjatë transmetimit të programeve zgjedhore nga radiot dhe televizionet publike dhe private.

Neni 136

Ankime

Subjektet zgjedhore mund të ankohen pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) për parregullsitë e vërejtura në pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga radio dhe televizionet publike dhe private. KKRT-ja i shqyrton ankesat dhe vendos brenda 24 orëve për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

PJESA E DHJETË FINANCIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 137

Financimi i zgjedhjeve

Shteti financon zhvillimin e zgjedhjeve sipas neneve 138 dhe 139 të këtij Kodi.

KQZ-ja administron fondet e caktuara për zhvillimin e zgjedhjeve sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

Neni 138

Selia, buxheti dhe personeli i KQZ-së

Selia e KQZ-së është në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Buxheti i KQZ-së përbën zë më vete në buxhetin e shtetit.

KQZ-ja pranon donacione që i shërbejnë procesit zgjedhor dhe që nuk cenojnë pavarësinë dhe autoritetin e saj.

Struktura dhe organika e administratës së KQZ-së përcaktohet me vendim të KQZ-së.

Neni 139

Fondet në dispozicion të partive politike

Përveç fondeve që përfitojnë sipas ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, partitë politike që janë regjistruar në KQZ, në përputhje me këtë Kod, përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për zhvillimin e zgjedhjeve.

Fondet e caktuara për financimin e partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje caktohen nga KQZ-ja brenda 30 ditëve nga miratimi i tyre në Kuvend. Pagesat bëhen nga Ministria e Financave pas njoftimit zyrtar nga KQZ-ja për mënyrën e ndarjes së këtyre fondeve.

Fondet e buxhetit të shtetit për financimin e partive politike në zgjedhje ndahen si më poshtë:

10 për qind e shumës ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive politike të regjistruara si pjesëmarrëse në zgjedhje;

30 për qind e shumës ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që aktualisht kanë deputetë në Kuvend ose, sipas rastit, anëtarë në këshillat e bashkive ose komunave;

60 për qind e shumës ndahet ndërmjet tyre në përpjesëtim me numrin e votave të fituara prej tyre në shkallë vendi në zgjedhjet e fundit për Kuvendin ose në zgjedhjet vendore.

4. Pas përfundimit të zgjedhjeve, partitë që nuk fitojnë më shumë se 2.5 për qind të votave, detyrohen të kthejnë shumat e ndara paradhënie, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 3 të këtij neni. Të gjitha fondet e ndara, sipas shkronjave “b” dhe “c” pikës 3 të këtij neni rishpërndahen pas përfundimit të zgjedhjeve midis partive që kanë marrë më shumë se 2.5 për qind të votave, në përputhje me përqindjen e votave të fituara nga secila prej tyre.

PJESA E NJËMBËDHJETË
ANKIMET KUNDËR VENDIMEVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Neni 140

Ankime

Vendimet e KQV-së mund të ankimohen brenda dy ditëve nga shpallja e tyre në KZZ ose, sipas rastit, në KZQV, të cilat vendosin për ankimin brenda dy ditëve. Kundër vendimit të KZZ-së ose KZQV-së mund të bëhet ankim brenda dy ditëve nga shpallja e tij në gjykatën e rrethit të vendndodhjes së selisë të komisionit, e cila vendos brenda tri ditëve. Vendimi i gjykatës së rrethit mund të ankimohet brenda tri ditëve në gjykatën e apelit, e cila vendos brenda 5 ditëve. Vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë.

Vendimet e KZZ-së ose KZQV-së, me përjashtim të atyre që parashikohen në pikën 1 të këtij neni, mund të ankimohen brenda dy ditëve nga shpallja e tyre në KQZ, e cila vendos mbi ankimin brenda dy ditëve.

Neni 141

Ankime në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë

Vendimet e KQZ-së në lidhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin dhe referendumet, si dhe pavlefshmërinë e tyre ankimohen në Gjykatën Kushtetuese brenda tri ditëve nga shpallja e tyre. Gjykata Kushtetuese i shqyrton ankimet dhe vendos brenda 10 ditëve.

Vendimet e KQZ-së në lidhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve vendore dhe pavlefshmërinë e tyre ankimohen në Gjykatën e Lartë brenda tri ditëve nga shpallja e tyre. Gjykata e Lartë i shqyrton ankimet dhe vendos brenda dhjetë ditëve.

Neni 142

Ankime kundër vendimeve të KQZ-së

Të gjitha vendimet e KQZ-së, përveç atyre që parashikohen në nenin 141 të këtij Kodi, mund të ankimohen në Gjykatën e Apelit të Tiranës brenda tri ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata e Apelit të Tiranës i shqyrton këto ankime dhe vendos brenda pesë ditëve.

Vendimet përfundimtare të KQZ-së për mospranim të kërkesës për referendum të përgjithshëm mund të ankimohen në Gjykatën e Apelit të Tiranës brenda pesë ditëve nga shpallja e tyre. Gjykata e Apelit të Tiranës vendos brenda dhjetë ditëve. Vendimi i saj është i formës së prerë.

Neni 143

Ankime për listat e zgjedhësve

Çdo zgjedhës, që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve sipas procedurës së parashikuar në kreun II të pjesës së katërt të këtij Kodi, mund të ankohet në gjykatën e rrethit jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo gjykatë vendos brenda dy ditëve.

Vendimi i gjykatës së rrethit mund të ankimohet brenda dy ditëve nga shpallja e tij në gjykatën e apelit, e cila vendos brenda tri ditëve. Vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë.

Neni 144

Afatet

Afatet e parashikuara në këtë pjesë zbatohen vetëm gjatë periudhës nga dita e shpalljes së datës të zgjedhjeve deri tri ditë pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

PJESA E DYMBËDHJETË
PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 145

Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve

Anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të këtij Kodi.

Neni 146

Votimi më shumë se një herë

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie deri në tre muaj.

Neni 147

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve

Braktisja e detyrës pa shkaqe të ligjshme nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie nga 6 muaj deri në 2 vjet.

Neni 148

Sanksione administrative

Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3.000 deri në 90.000 lekë.

Shkelja e rregullave të parashikuara në këtë Kod nga radiot dhe televizionet publike dhe private përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100.000 deri në 500.000 lekë.

Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1.000 deri në 2.500 lekë.

4. Për shkelje e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, dënimet jepen nga KQZ-ja. Dënimet, për shkeljet e pikës 3 të këtij neni, jepen nga të gjitha komisionet e zgjedhjeve.

PJESA E TREMBËDHJETË RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 149

Ruajtja e dokumentacionit

1. Asnjë procesverbal i KQV-së, KZQV-së, KZZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të shkatërrohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

2. Të gjitha procesverbalet e KQV-së ose të çdo komisioni tjetër të ngritur nga KZQV-ja ose KZZ-ja i jepen KZQV-së ose KZZ-së në mënyrën dhe kohën e caktuar nga KQZ-ja.

3. KZQV-ja dhe KZZ-ja mbajnë nga një kopje:

- a) të dokumentacionit të kandidatëve dhe partive politike që marrin pjesë në zgjedhje;
- b) të listës së emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KQV-së dhe komisioneve të tjera;
- c) të listës së qendrave të votimit;
- ç) të listave të zgjedhësve për njësinë zgjedhore;
- d) të emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZQV-së ose KZZ-së;
- dh) të hartës së njësisë zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;
- e) të përshkrimit me shkrim të kufijve të të gjitha njësive zgjedhore;
- ë) të dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, të njoftimeve zyrtare për zgjedhjet të KZQV-së ose KZZ-së, të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për çdo qendër votimi dhe të shpalljes përfundimtare të rezultateve; dhe
- f) të deklaratës së shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.

4. Dokumentet origjinale, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, i dërgohen KQZ-së brenda

tre muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. KQZ-ja mban një kopje dhe ia dërgon dokumentet origjinale Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e kërkuar prej tij dhe brenda 12 muajve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

5. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZQV-ja ose KZZ-ja, komisioni i dërgon KQZ-së, në mënyrën e caktuar prej saj, të gjitha kutitë e vulosura të votimit me procesverbalet e votimit, vulën e komisionit, fletët e votimit të përdorura në zgjedhje, si edhe fletët e votimit të papërdorura.

6. Me marrjen e kutive të votimit dhe fletëve të votimit të papërdorura dhe pas përfundimit të afatit për ankimet, sipas pikës 5 të nenit 113 të këtij Kodi, KQZ-ja hap të gjitha kutitë e votimit, nxjerr procesverbalet e votimit, si dhe tabelat dhe procesverbalin e numrit të fletëve të votimit, dhe ia dërgon ato Arkivit Qendror të Shtetit në mënyrën e caktuar prej tij. Të gjitha fletët e votimit dhe kundërfletët digjen nën mbikëqyrjen e KQZ-së.

PJESA E KATËRMBËDHJETË DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 150

Mandati i anëtarëve të KQZ-së dhe efektet financiare

Neni 17 i këtij Kodi nuk mund të interpretohet se cenon vlefshmërinë e emërimeve të anëtarëve të KQZ-së të bëra përpara hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, si dhe efektet financiare në lidhje me organizimin dhe funksionimin e KQZ-së fillojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Neni 151

Mbledhja e parë e KQZ-së

Brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, Presidenti i Republikës thërret me dekret mbledhjen e parë të KQZ-së, ku zgjidhet kryetari i KQZ-së, në përputhje me nenin 27 të këtij Kodi.

Neni 152

Zgjedhjet vendore të vitit 2000

Mandati i kryetarëve të bashkive dhe komunave dhe të këshilltarëve vendorë të zgjedhur në vitin 1996 përfundon me mbledhjen e parë të këshillit vendor të zgjedhur në vitin 2000 në bashkinë ose komunën përkatëse, e cila duhet të zhvillohet jo më vonë se 20 ditë pas përfundimit të periudhës zgjedhore.

Zgjedhjet vendore të vitit 2000 zhvillohen jo më vonë se 1 nëntor 2000.

Për zgjedhjet vendore të vitit 2000, qendrat e votimit hapen në orën 700 dhe mbyllen në orën 1800.

Neni 153

KQZV-të dhe KQV-të për zgjedhjet vendore të vitit 2000

1. Pavarësisht nga pika 1 e nenit 38 dhe pika 1 e nenit 43, për zgjedhjet vendore të vitit 2000, KZQV-ja dhe KQV përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të emëruar respektivisht nga KQZ-ja dhe KZQV-ja me propozimin e shtatë partive politike që kanë fituar më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet vendore të vitit 1996.

2. Anëtarët e këtyre komisioneve duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë Kod.

3. KQZ-ja (KZQV-ja) emëron kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZQV-së (KQV-së) mbi bazën e propozimeve të bëra nga KZQV-ja (KQV-ja). Kandidatët për kryetar dhe zëvendëskryetar të KZQV-së (KQV-së) propozohen nga dy partitë politike që kanë fituar më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet vendore të vitit 1996.

4. Për efekt të zbatimit të këtij neni numri i votave të fituara në shkallë vendi nga koalicionet e partive ndahet në mënyrë të barabartë midis partive të koalicionit, me përjashtim të rasteve kur për

këtë ka marrëveshje midis tyre.

Neni 154

Përgatitja e Regjistrimit të parë Kombëtar të Zgjedhësve

Për zgjedhjet vendore të vitit 2000, Këshilli i Ministrave, nëpërmjet organeve të qeverisjes vendore, si dhe zyra të gjendjes civile, përgatit Regjistrin paraprak Kombëtar të Zgjedhësve dhe ia dorëzon atë Drejtorisë së Regjistrimit të Zgjedhësve të KQZ-së jo më vonë se 25 gusht 2000.

KQZ-ja i dërgon çdo KZQV-je një kopje të listave paraprake të zgjedhësve për njësinë zgjedhore përkatëse të nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve jo më vonë se 28 gusht 2000. Për këto zgjedhje zbatohen, për aq sa është e mundur, procedurat e kreut II të pjesës së katërt, me përjashtimet e mëposhtme:

Perioda e rishikimit të listave përfundon 17 ditë para datës së zgjedhjeve dhe pas kësaj KZQV-ja i dërgon KQZ-së listën e rishikuar të zgjedhësve;

KQZ pasi miraton, i dërgon KZQV-së listat përfundimtare të zgjedhjeve të nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Zgjedhësve jo më vonë se 7 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Deri në krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, KQZ-ja përgatit listat e zgjedhësve për zgjedhjet vijuese, në bazë të listave të zgjedhësve të zgjedhjeve të mëparshme, të cilat rishikohen nga zyrat e gjendjes civile. Për këto zgjedhje zbatohen, për analogji, edhe procedurat e Kreut II të Pjesës së Katërt të këtij Kodi.

Neni 155

Votimi me dokument identifikimi

Për zgjedhjet vendore të vitit 2000, zgjedhësit që nuk janë pajisur me kartën e zgjedhësit mund të votojnë me një dokument identiteti me fotografi, të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, sipas udhëzimeve të nxjerra nga KQZ-ja.

Neni 156

Programet informative të KQZ-së

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik cakton 4 orë transmetimi falas në radio dhe televizion për programet informative të KQZ-së, të cilat informojnë publikun për regjistrimin e zgjedhësve, lëshimin e kartës së zgjedhësit dhe për dispozitat e këtij Kodi.

2. Katër orët e transmetimit falas përdoren para caktimit të datës së zgjedhjeve. Ato nuk janë pjesë e minutazhit që KQZ-ja përfiton gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Neni 157

Komisioni i parë i Kufijve të Zonave Zgjedhore

Komisioni i parë i Kufijve të Zonave Zgjedhore krijohet dhe funksionon në përputhje me nenet 68 deri 73 të këtij Kodi, përveç sa më poshtë:

a) Komisioni përdor të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve të miratuar nga KQZ-ja për zgjedhjet vendore të vitit 2000.

b) Komisioni krijohet jo më vonë se 1 shtator 2000.

c) Komisioni i paraqet Kuvendit raportin përfundimtar jo më vonë se 15 janar 2001.

ç) Ligji për zonat zgjedhore miratohet nga Kuvendi jo më vonë se më 28 shkurt 2001.

2. Në rast se Kuvendi nuk e miraton ligjin për zonat zgjedhore brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Presidenti i Republikës cakton kufijtë e zonave zgjedhore në përputhje me raportin përfundimtar të Komisionit të Kufijve të Zonave Zgjedhore. Kufijtë e caktuar sipas kësaj pike, mbeten në fuqi deri në rishikimin e ardhshëm të tyre sipas nenit 68 të këtij Kodi.

Neni 158

KZZ-të dhe KQV-të për zgjedhjet e vitit 2001

1. Pavarësisht nga pika 1 e nenit 32 dhe pika 1 e nenit 43, për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2001, KZZ-ja dhe KQV-ja përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të emëruar, përkatësisht nga KQZ-ja dhe KZZ-ja, me propozimin e shtatë partive politike që kanë fituar më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 1997.

2. Anëtarët e këtyre komisioneve duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë Kod.

3. KQZ-ja (KZZ-ja) emëron kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZZ-së (KQV-së) mbi bazën e propozimeve të bëra nga KZZ-ja (KQV-ja). Kandidatët për kryetar dhe zëvendëskryetar të KZZ-së (KQV-së) propozohen nga dy partitë politike që kanë fituar më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet e vitit 1997.

4. Për efekt të zbatimit të këtij neni, numri i votave të fituara në shkallë vendi nga koalicionet e partive ndahet në mënyrë të barabartë midis partive të koalicionit, me përjashtim të rasteve kur për këtë ka marrëveshje midis tyre.

Neni 159

Aktet nënligjore të KQZ-së

KQZ-ja nxjerr rregullore dhe udhëzime në zbatim të këtij Kodi.

Neni 160

Shfuqizime

Ligji nr. 7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”; ligji nr. 7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”; ligji nr. 7866, datë 6.10.1994 “Për referendumet” me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë Kod, shfuqizohen.

Neni 161

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2616, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani